

# Oral History Kosovo

## INTERVISTË ME MEJREME SHEMËN

Prishtinë | Data: 18 korrik, 2023

Kohëzgjatja: 163 minuta

Të pranishëm:

1. Mejreme Shema (e Intervistuara)
2. Anita Susuri (Intervistuesja)
3. Latra Demaçi (Intervistuesja)
4. Ana Morina (Kamera)

*Simbolet e komenteve në transkriptë te komunikimi jo-verbal:*

- ( ) - komunikim emocional
- { } - i intervistuar shpjegon me gjeste

*Simbole të tjera në transkriptë:*

- [ ] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin

Fusnotat janë shtesa editoriale që jepin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.

## Pjesa e Parë

**Anita Susuri:** Zonja Mejreme, nëse mundeni me u prezantu, me na tregu diçka për prejardhjen e juj, kujtimet e para të fëmijërisë?

**Mejreme Shema:** Po. Unë jam Mejreme ose Mehreme e regjistruar, Berisha, bija e Liman Berishës. Baba jem ka jetu në fëmijëri në fshatin Berishë në Drenicë. Ndërsa unë kom lindë në fshatin Leletiq, tash quhet Reze, në komunën e Lipjanit. Kom pasë ni fëmijëri të mirë se kam lindë pas Luftës së Dytë Botërore, do të thotë në përfundim të Luftës së Dytë Botërore. Për fat t'keq i kam dy ditëlindje (qeshë), gabimisht më kanë regjistru, me 10 shtator 1945. Ndërsa unë kam lindë me 8 nëntor 1945. Kjo gati osht' datë që ka përfunduLufta e Dytë Botërore.

Kështu që edhe gjyshja edhe baba ose ngjarje të tjera, me djalin e axhës që jemi moshatar i kemi tri javë ndërmjet, nuk është data e saktë që jom e regjistrune. Po s'më ka bo përshtypje, ka mbetë qashtu, kurrë s'kom insistu me e heq. Po gjithnjë e kom mbajtë datën e ditëlindjes sepse baba jem në kuletë i mbante të shkrune po ato kanë qenë me numra romak. E atëherë njerëzit që kanë punu në administratë sado pak kanë ditë me shkru dhe s'e kanë kuptu. Muji njëmbëdhjetë ka dalë muji nantë mrapsh (qeshë). E kështu që ka mbetë ashtu.

Vetëm në dokumenta që janë kryesor, leternjoftimi, kjo, pashaporta e tjera, diploma e tjera i kom në atë datë. Për arsyse se është legjitime ashtu e regjistrune. Kurse tjerat gjithmonë i marrë me datën që është e vërtetë. Familja jeme ka ardhë herët do të thotë prej Drenicës në Rrafsh të Kosovës. Duke pa se fshati Berishë ka qenë ma i vogël, nuk ka pasë përspektivë për punë e për tjerë boll. Baba jem ka qenë domethonë tre djem edhe dy vajza, babgjyshi im i ka pasë edhe ka dëshiru t'ju len' ni punë, t'ju gjen ni punë, jetë ma t'mirë se që ka qenë ajo në fshatin Berishë.

Kshtu që ka hulumtu, ka hulumtu dhe në fund ka ardhë deri në Magure. Aty është taku me ni hoxhë, zakonisht njerëzit në treg në kto, t'ejteve është bo tregu në Magure. Janë taku njerëzit, dikush ka ble diçka, dikush ka shitë diçka. E gjyshi jem është marrë me nifar' tregtie se ka pasë si kështu hobi duhani që ka qenë pak ilegale dhe me do sene tjera. Ka pasë ni han në Banjë të Drenicës atje. Gaz për drithë e

sene, gjanat ma elementare domethonë m'i shitë edhe naj kush kur mbetet s'ka ku me fjetë diçka rroktar e sene ka pasë naltë bujtinën që i ka marrë me fjet.

Kështu që ai ma rrallë ka ardhën do të thotë në shtëpi. Gjithmonë ka qenë do të thotë i nxanun, çdo tre muj kështu se gjyshja nuk e lavdon shumë, thotë, "M'ka lanë veç me fmi", (qeshë). Kanë banu te babgjyshi, do të thotë te baba i nanës tem. Ai e ka marrë n'fillim, ju ka lëshu ni vend me banu të cilët pastaj baba jem është marrë me bajtjen e ujit të punëtorëve në Golesh. Se Goleshi ka qenë minierë që ka punu edhe gjatë luftës edhe pas luftës. Gjithmonë... bile deri vonë e ka pasë drejtorin italian, Makarenku, gjithnjë e përmenke baba edhe m'ka mbetë në kujtesë ajo.

Ka bajtë ujë punëtorëve se ka qenë ma i ri. Ma vonë pastaj ka vazhdu me punu. Ka punu edhe në minierë besa, në horizontin e nëntë. Kurse mixha jem ma i madh, Muhammed Berisha, ka mbajtë kopshte, i rimbajtë kopshtet nëpër ato fshatra aty. Për me jetu do të thotë diçka me punu. Babgjyshi jem ka punu do të thotë aty në Qylagë ku janë strehu niherë se s'kanë pasë banesë as shtëpi. Te fqinjët me mbajtë kopshtin, me punu me ara e tjera. Tri vjet kanë jetu te gjyshi jem, do të thotë te baba i nanës dhe kanë ble këtë tokë në Leletiq që quhet tash Rreze. Ka qenë e ni begut të madh që Turqia që i lente njerëzit e ju jepte me mirëmbajtë tokën. Mas ni periudhe kah viti 1912 e tjera, Serbia ose si ka qenë përpara e thirrur...

**Anita Susuri:** Mbretëria.

**Mejreme Shema:** Mbretëria serbe ka marrë tokat shqiptarëve edhe ju ka dhanë atyne që vijnë me banu. Do të thotë në Vrellë, në Harilaq, në Suhadoll, do të thotë, në komunën e Lipjanit. Tokat për me punue malin do të thotë janë konë kah fshati Rreze, Leletiq edhe deri te Mirena ku ndahet Rrafshi i Kosovës me Drenicën. Është ni qeshme gjithmonë qet' ujë, currel është qujtë. Ni fjalë shumë e mirë se po curron ujë vazhdimi.

Kur... e kanë ble domethonë prej serbëve e kanë ble. E kanë shitë tokën se ata nuk e kanë punu, ata kanë jetu ose në Vrellë ose në Harilaq në vendet ma rrafsh ku është. Kanë qenë gjithmonë të punësuar në Golesh, në administratë e tjerë kështu që nuk kanë passë nevojë shumë me punu tokën. Kështu tash ky begu që ka pasë me ni hapësirë t'madhe ia kanë marrë. Ky i ka marrë pastaj do kusheri t'vet, Kastrat, dhe i ka pru aty me shtëpija.

Është domethonën babgjyshi i tij ka qenë, baba i tij ka qenë domethonë si beg kurse djali Destani, Destan Kastrati, e ka trashëgu do të thotë shumicën e tokës së babës së tij edhe kanë ardhë njerëzit kanë lëvizë. Atëherë nuk ka pasë kufij. Kanë ardhë, ju ka dokë ma mirë me jetu aty prej Suhadollit, kanë ardhë prej ni vendi tjetër edhe kanë lëvizë. Kështu që ka pasë Kastrat, ka pasë Suhadoll, ka pasë Çerkini e tjera. Po ni lagje e vogël ka qenë do të thotë. Sot m'kujtohet e di ku cilat kanë qenë shtëpijat.

Kurse, sot kanë bo shtëpija t'bukura, shtëpija t'mdhaja fmitë e tyre, janë zgjeru, kanë dalë jashtë, kanë punu. Domethonë jeta ka ndryshu për të mirë. Ka qenë varfëri e madhe pas Luftës së Dytë Botërore, nuk ka pasë me hangër bukë, nuk ka pasë punë do të thotë shumica. Megjithatë atë tokë që e kanë pasë e kanë punu, me atë edhe kanë mbijetu. Në atë kohë, domethonë, serbët janë mundu me marrë nëpër magje bukën, me ia çu të tjerëve, do të thotë serbëve. Shqiptartë kanë kundërshtu.

Ka qenë puna edhe mas luftës meniherë ferekha, heqja e ferekhes. Axha jem dy vjet i ka hangër burg për shkak se ka thanë, "Shqiptartë nuk kanë të drejta dhe si po doni me marrë bukën e shqiptarëve", dhe u shku ua ka marrë në Vrellë serbëve me ia prap shqiptarëve. Edhe për ferekhe ka thanë, "Pse po merrni me ata? Kush don e ban kush s'don s'e ban", se gruja e tij s'ka pasë ferekhe, ka qenë, vetëm ni shami e bante. Po kanë qenë gjëna do të thotë që me mujtë me acaru gjendjen, me bo edhe ma t'veshtirë sesa që është jeta.

Kështu që në Luftën e Dytë Botërore baba jem, mixha jem, të gjithë kanë marrë pjesë. Në atë periudhë Rifat Berisha me dy bashkëfshatarët e tij, njëri i Sadllarit njëri i Baicës, Shefqet Kapetani është thirrë, Shefqet Bylykbashi edhe i Sadllarit Ibrahim Banushi, qashtu diçka janë zgjedhë me shku me kry shkollën ushtarake në Tiranë, në Shqipëri. E kanë kry dhe domethonë lufta i ka nxanë duke punuar si ushtar. Rifati ka punu në kufi me Greqinë, tjetri, Shefqet Kapetani ka qenë pak me këtë grupin nationalist e tjera.

Janë nda si thojnë gjërat ndryshe ndryshe. Kështu që mirë osht' dhanë ni urdhër ose është marrë ku ta di unë që edhe Shqipëria edhe populli i Kosovës duhet të hijnë në luftë, Luftë Nacional Çlirimtare. Me qëllim që në fund të luftës të bëhet bashkimi i Kosovës me Shqipërinë. Kjo ka qenë aspiratë e t'gjithë shqiptarëve gjithmonë edhe tanë kohën. Por, nuk janë kriju kushtet. Gjithmonë është luftu, gjithmonë janë ndjekur ata që kanë pasë kësi aspirata.

Pastaj ka qenë ajo kur në luftë kanë marrë pjesë grupe i ballistëve, grupe komuniste e tjera. Jo pajtimi, pajtimi i vonshëm, vrasja. Mandej kanë vra, disa i kanë burgosë. Vet i kanë çelë rrugën që t'iknin për Greqi e vende tjera. Megjithatë i kanë zanë në kufi në Maqedoni dhe i kanë vra shumicën e tyne që kanë dashtë me ikë e sene. Është bo ni thirrje që ata që nuk kanë përly durtë me gjak të dorëzohen. Ka pasë ni mundësi do të thotë prej dënimit me vdekje, s'paku me bo ni dënim ma të butë.

Kështu që edhe Shefqet Kapetani në qat' periudhë është dorëzu me këtë qëllim që... ai ka qenë nationalist po ka qenë për të mirën e popullit e sene po nuk ka bo vrasje dhe është dënu. Bile me ni moment baba tregonte, "Kur shkova me pa Rifatin në Prishtinë", gruja e tij ka qenë gjirokastrite, edhe e pytke, "çka u bo puna e Shefqet Kapetanit", "Ih Mihri, mos më pyt për Shefqetin, pytëm çka po bohet për Kosovën". Domethonë qaq keq ka qenë, qaq problem ka pasë sa që e kom harru Shefqetin. Nuk po dënohet me vdekje po ta mban burgun, dikur e mban ni pjesë edhe del. Ashtu ndodhi. Doli e kryjti burgin, nantë vjet a sa ka nejt. Ka jetu ni kohë të gjatë besa në Baicë atje.

**Anita Susuri:** E baba juj, a ka qenë me...

**Mejreme Shema:** Baba jem domethonë ka qenë edhe kusheri me Rifat Berishën po edhe si truprojë e tij gjatë luftës. Ka marrë pjesë në luftë, ka, me Rifatin kanë bo roje të gjitha ato. Në fund kur osht' kry lufta, tre muj ditë ka nejt në parti. Sepse tha, "S'mujsha me nejt në parti se ishte puna për me i përcjellë njerëzit që unë i marrsha që janë njerëz revolucionar, njerëz atdhetar, njerëz për Shqipëri", do të thotë bashkimin e këtë, e ata domethonë, i bonin ato që me ndjekë tjetrin, me ndjekë tjetrin. Edhe e gjun librezën thotë, "Unë nuk jom për këtë punë" (qeshë).

Pastaj, e çojnë ma vonë për shkak të kësaj e dënojnë me shku me punu në minierë në horizontin e nantë. Ka punu derisa ka dalë në penzion. Se janë ato vitet ma të shkurta, nuk janë një vit kalendarik po vite ma të shkurt për shkak të punës që ka qenë e vështirë në miniera...

**Anita Susuri:** Ka qenë në Minierën e Goleshit?

**Mejreme Shema:** Po, në Minierën e Goleshit. Bile ni kohë e ka udhëheq drejtorinë me, gjatë periudhës të luftës kur kanë qenë italianët e tjerë, e ka çu me qerre që themi ne. Qysh i thonë edhe ndryshe nifar'...

**Anita Susuri:** Po me kuaj, me qerre.

**Mejreme Shema:** Deri në Lipjan deri në Prishtinë se ai ka udhëtu e kështu. Thotë, "Kom marrë shumë sene të mira prej tij se gjithmonë m'ka mësu për të mirë". Kom lindë, thashë, këtë periudhë do të thotë të përfundimit të luftës. Para meje ka lind poashtu vajzë, motra ime e cila nuk e di datën saktësisht, po duhet me qenë dikund një tri vjet ma e madhe se unë. Do të thotë '42-shi ashtu. Se baba im u martu në '40-ten e tani nifar' mënyre e ka grabit nanën time, është ni histori tjetër.

Ajo vajzë ka jetu një tri vjet. Pasi kom lind unë domethonë gjashtë mujsh kom qenë, ajo ka vdekë prej kollit të keq, prej fruthit. Se atëherë s'ka pasë vaksina për fëmijë, tek '52-ta apo '55-ten vaksinat e para kanë ardhë. '52-ten po më doket se e di unë kom fillu shkollën, klasën e parë kemi fillu m'i marrë vaksinat. Përpara ka qenë vdekshmëria e madhe, qoftë të fëmive të posalindur, qoftë të nanave lehonë sepse s'ka pasë... e mbaj mend, për vete s'e mbaj mend kur kam lind, nuk e mbaj mend vllaun e dytë.

E mbaj mend vllaun e tretë pak. Ka qenë ni grue si mami m'i thanë po s'ka qenë mami me shkollë ashtu po ka ndihmu gratë me lind. Baba shkonte gjithnjë e marrke se nana ka pasë lindjet e vështira dhe ajo vinte me ndihmu. Halla Elmaz u thirrke. Bili nipi i saj osht' ka qenë deputet, ky Rugova, s'di, ky i Lipjanit. Kam pasë masanej vllaznit, vllavi mas meje, vllavi tjetër, vlla bineq dy. Dhe në fund '57-ten ka lind edhe fëmijën ma të fundit do të thotë Alushin, që ia kanë ngjitë emrin e babgjyshit dhe e ka pasë njënin nga bineqët që ka vdekë. Kurse tjetri ka jetu dhe ka vdekë tash para gjashtë vjete kështu.

Kështu që po thom jeta ka qenë e vështirë për të gjithë por është ni, si me thanë, ni vullnet i madh i prindërve të mi, i gjyshës, i hallës, krejtve që kanë punu shumë. Kanë punu tokën, kanë mbjellë duhan, kanë bo punë të randa për me jetu. Kështu që nuk e kemi ndi na fort skamjen n'atë kuptim. Por kemi pasë mundësi me ndihmu edhe të tjerët në rast nevoje. Dikush s'ka pasë i kemi çu mill ose i kemi ble ose diçka.

Kur kom fillu në shkollë me shku, disi gjithmonë e kom pasë atë përshtypjen që ne jemi ma të pasurit. Se meniherë baba jem na ka ble librat, na ka ble mixha me ato tabletat e vogla me shkru me shkumës. Më kujtohet si sot kur kemi shku mas dy javë dite, s'e di qysh e kom thy unë temën e ia kom marrë djalit të mixhës t'u menu që ai osht' i zoti i shpisë atij ma lehtë ia blen. Kur kemi shku në shpi ai thotë, "Jo s'osht", unë s'e kom thy", unë, "E ke thy e ke thy". Në mramje baba thotë, "A din çka, drejt me m'kallxu", "Po bre babë, s'e di qysh e kom thy po nuk e di pse thashë ashtu", a din. U pajtum.

Kemi shku shumë mirë, asniherë s'kemi pasë zënka ose diçka, nuk di. Tash fëmitë po rriten vet, na jemi rritë bashkë, kemi lujtë. Unë për veti s'kom lujtë lojna me vajza me sene se kom pasë ma shumë djem të axhës e sene e kom lujt me lojna të djemve. Atëherë s'kishte me ble top, na maroje nana ni top s'kishim lojna pushka, traktora e sene po me shallvare na maroje pushkën edhe u gjujshim pastaj gjerman e partizan (qeshë). Kështu lojna domethonë gjithë ne. Shumë pak kam lujtë me vajza. Gjithmonë kam lujtë me djem.

Po kom qenë e dobët kështu nga shëndeti, s'kom pasë sëmundje po vet natyra. Baba gjithmonë bëhej marak pse kam, jam kështu a din. Kam ardhë në Prishtinë besa me m'kontrollu, mjeku i thotë, "Shnosh mirë osht' vet e ka". Kur kom ardhë, kur e kom kry shkollën tetë vjeçare do të thotë koha pubertetit e sene meniherë e kom ndryshu, jam shëndoshë lëvizjet ma të pakta, s'kom pasë livadh e ata me vrapu, malin me shku në zabel dhe krejt. Po megjithatë kemi kalu mirë.

Kemi pasë ble ni shtëpi të vogël për neve me u shkollu. Me neve u dashtë me ardhë gruja axhës, ajo ka marrë fëmitë e vet, une kom jetu me ta. Une e kom pasë bursën nga Lipjani, kom qenë e vëtmja vajzë në fillim do të thotë që kom vazhdu shkollën e mesme. Ka qenë si, si, me thanën, osht' çelë këtë vit Këshilli Ekzekutiv tash që është parlamenti, qat' vit është maru edhe ende s'ka qenë i rregullun kur kom ardhë me pa me ditë ku duhet me shku në shkollë se nuk e kom ditë ku osht' shkolla edhe a jom pranue.

Veç i kom çu dokumentat me letër, e kanë gjetë emër, mbiemer, po. Se ka qenë domethonë shkëlqyshëm me qenë të gjithë edhe gjitha vitet. Kështu e kom plotësu kushtin e isha pranu. Kur shkoj mas ni javë dite kom shku, pastaj u dashke me ato për shkollën e mesme me vesh uniformën e zezë me jakë të bardhë. Ndërsa kur e bonim praktikën, mantillin me pasë e të gjitha këto.

**Anita Susuri:** Në cilën shkollë keni qenë?

**Mejreme Shema:** Kemi qenë afër Elena Gjikës, tash që ka qenë shkolla e muzkës. Ka qenë ni shkollë e vogël, ni oborr t'vogël atëherë. Për herë të parë që është çelë kjo shkollë, osht' qujtë si shkollë ndihmëse. Nuk është motër medicionale po na kena mësu edhe me dhanë injeksione edhe infuzione e krejt po ka qenë kujdesi për të sëmurin, kështu e ka pasë thirrjen. Ni klasë ka qenë shqiptar, vajza shqiptarë 33 veta, ni klasë ka qenë e kombinune prej gjimnazit djem edhe vajza edhe ni klasë serbët, do të thotë vajza, si paralelja jonë.

Ka qenë si të them, ni hartë e Kosovës me rrëthinë. Se ke pasë dy prej Kamenicës, dy prej Vitisë, ni prej Lipjanit, unë kam qenë. Mandej prej Suharekës nji, Gjakovës ka qenë pesë a gjashtë, Prishtinës ka pasë ma shumë. Kështu që ka qenë ni klasë me 33 veta. Në afatin e parë në qershori e kemi kry do të thotë 28, dy kanë kry pak ma vonë kurse dy e kanë lanë ma herët dhe njana ka kry daktilografinë, tjetra ka kry diçka tjetër po janë punësu në atë periudhë.

Nuk ka qenë fort problem m'u punësu sepse ka pasë nevojë. Tash në qët' kohë do të thotë vitet e '60-ta kur erdha në Prishtinë më mungonte fshati, më mungoshin njerëzit vllaznit, nana, baba po megjithatë gjeta shoqëri me shoqe, me shokë dhe u inkuadrova do të thotë në nifar' mënyre. Kisha qef me shkru, shkruja nga pak, merrsha pjesë në këto mramjet letrare në Gjimnaz Sami Frashëri, pastaj, Ivo Lola Ribar u thirrke atëherë, shkolla normale, kështu.

Kështu që jom taku me disa shokë. Bile në vitin e tretë kom marrën shpërblimin e dytë. Ka qenë për Luftën Nacional Çlirimtare dhe Zeqir Gërvalla ka marrë çmimin, jo, mirë thashë, Gërvalla, Zeqiri, po. Edhe këtë... ni... shpërblimin e tretë ni serb. Shkum në Këshillin Krahinor m'i marrë shpërblimet. Unë kisha dëgju për Zeqirin po nuk e njifsha kështu. Aty u njoftëm. Ka qenë shumë ni djalë i mirë, shumë një i afërt, i disponueshëm. Shkrunte dhe ka shkruar edhe më vonë.

Unë shkruaja ma dembelicë ashtu, ashtu kur m'u teke diçka me pasë. Po edhe në vitin e parë kemi pasë landë ma shumë serbisht se shkolla për herë të parë. Gjuhën shqipe e kemi pasë do të thotë, ka qenë ni student, Haxha, Haxha thirrej, Halil Haxha po më duket. Gjithë e kujtoj kur vinte në klasë, "Vid, vid, vid pëllumbeshë", edhe ni ditë i dalë përpëra, "Çka osht' kjo profesor kështu?" Thashë, "Çka u bo? Pse po flet serbisht? Krejt i kemi serbisht landët edhe shqip", tha, "Nuk osht' serbisht", tha, "po osht' ndjellja e pëllumbave", "Aiii {onomotope}" i thashë...

Po kemi kalu shumë mirë. Pastaj na u kanë ndryshu shpesh, ai ka shku ka ardhë ni profesor tjetër e tjerë. Në fund te kjo Naime Qelérxiu na ka dhanë edhe ajo e vlerësoj hartimin, se duhesh me bo hartim e tani me pa kush çka me zgjedhë. Mandej pak e zgjerova, e mora shpërblimin e dytë. Mirë ishte për Luftën Nacional Çlirimtare pak e lidhsha se ajo shkrimtare e din vet çka ka dashtë me folë e çka me thanë.

Tregime e këto ma pak kanë qenë të zhvillune për arsyen se vështirë, vështirë ke mujtë me kamufllo gjanat. Kurse poezia lirike sidomos e këto është ma e lehtë sepse ti e din çka ke dashtë me thanë, tjetri

nuk e din. Mundet me hamendje me folë e me thanë po realitetin ma tepër... për shembull, e kom botue ni poezi në zërin për nanën e Rifat Berishës, "Nana me katër skiftera". Unë ia kom kushtu asaj por forma si e kom bo osht', ka dalë nana e ushtarëve. Domethonë diçka që kur e pashin disa, "Qysh bre guxove me botu?" "More kom botu për nanat shqiptare nuk e kom botu për ni nanë", e kështu me radhë, kështu ka qenë.

**Anita Susuri:** Zonja Mejreme, desha m'u kthy pak te pjesa kur thatë keni ardhë në Prishtinë. Kjo ka qenë afërsisht në fillim të viteve...

**Mejreme Shema:** Kur kom ardhë në Prishtinë ka qenë viti '60, shtator.

**Anita Susuri:** Qysh ju është dukë Prishtina juve? A ka qenë hera e parë që keni ardhë?

**Mejreme Shema:** Jo, unë kom ardhë si fëmi në Prishtinë. E mbaj mend ni kthesë te hamami atje, kanë banu pikërisht këta kushërit e tonë. Kur vishim në Prishtinë për ndonjë nevojë a me shku te mjeku a diçka, kthenim i takonim kusherit tanë. Kështu që kam ardhë dy herë, tri herë si fëmi. E mbaj mend domethonë pak ashtu po ma e re kom qenë.

Për herë të parë domethonë... kom ardhë pastaj në spital gjatë shkollës filllore, e kom thy dorën në shkollë edhe arsimtari më ka përcjellë te mjeku mandej ata me ambulantë m'kanë çu në spital. Kom nejt ni javë edhe axha u ardhë m'ka marrë. U ardhë me m'pa ka thanë nashta e lëshojnë, ai ka ardhë në qytet edhe veç i ka thanë dikujt, qyre filan veni jam, "Te kafja Skënderbeu", para teatrit ka qenë ajo, "kallxomni që e kanë lëshu vi e marr". Këtë herë.

Ma herët kam qenë me djalin e axhës. Na kishim bagëti shumë edhe e përdornim qumështin me pi. Kur i mjelshim bagëtinë e pa vlu e përdorshim. Djali i axhës i bohen parazitet, pesë metra e sa, u dashke me shku në spital. Po u dashke me shku se edhe unë isha gjithmonë me ta dhe në spitalin e fëmive ka qenë ajo e vogël, spitali i pulmologjisë, domethonë i sëmundjeve të mushkërive dhe spitali i fëmive ka qenë ni katësh. Si sot e mbaj mend pastaj klastë kur kemi qenë na që punojshim në universitetin e punëtorëve thojsha, "Qitu kom qenë e shtrime në spital" (qeshë).

Kështu që pak, pak qendër te teatri qaty u takoja me mixhën derisa u gjindej diçka me shku. Atëherë ka qenë vështirë edhe s'ka pasë autobusa kumeditë çka. U dashtë me prit dikënd ose diçka ose ka ardhë me punë. Ka ardhë ni diçka na ka marrë e sene. Kur kom ardhë për shkollë të mesme, me t'thanë të drejtën m'u ka dokë si në katun (qeshë). Se nuk ka pasë kumeditë çka. Ka qenë qikjo rruga që është korzoja, anën, qito ndërtesa anën e poshtme dhe anën kah teatri komiteti ka qenë ajo ku osht' tash kafiteritë e sene. Nuk ka pasë kumeditë çka.

"Grandi" u maru pak ma vonë. Ka qenë aty baza ushtarake, ka qenë ni bazen në fillim për ushtarë e tjera. Kaniherë qytetarët me leje, me shku me u la. Nuk ka pasë... Ulpiana shumë vonë është bo ni

pjesë. Pjesa këtu përmi [rrugën] "Agim Ramadani" ka qenë krejt ara. Vetëm qendra këtu te [shkolla] "Gjergj Fishta" kjo pjesa te [rruga] "Bajram Kelmendi", "Xhavit Mitrovica" rruga juve, këto kanë qenë shtëpia banuese, qikjo pjesë. Nën hekurudhë qajo që thashë, postderë [nënlum], rruga e Llapit deri te kjo medresa, qikjo ka qenë. S'ka qenë kjo hiç Kodra e Trimave, krejt shprazët.

Kur shkojshim me bo praktikën në spital, nëpër ara. Si kalojshe tash ku osht' posta s'ka pasë shtëpija, krejt ara, kollomoq, grun e tjera. Kur kom fillu me punu në spital qashtu ka qenë domethonë ende s'kanë bo... pastaj ma vonë janë ndërtu ni pjesë atje, ni pjesë atje e kështu me radhë...

**Anita Susuri:** E kjo pjesa, Pejtoni që osht' tash, universiteti, thojnë që aty ka qenë në kohën e Luftës së Dytë një si kamp...

**Mejreme Shema:** Po ajo osht' maru kjo Katedralja, aty ka qenë. Aty ka qenë "Xhevdet Doda", Gjimnazi "Xhevdet Dodës". Pastaj te fakulteti kanë qenë disa kazerma të luftës, të ushtarëve, krejt ajo pjesë. Deri vonë kanë qenë disa, banojshin njerëzit i patën uzurpu, nuk di po shqyr që u bo qiky nën kalimi dhe u pastru ajo, u rregullu mirë. *Gradiq* [srb.: qyteza] Pejtoni ka pasë pak po ka qenë ni infrastrukturë e mirë. Ka qenë ni ndërtesë pak si ma e madhe ni katëshe, aty banojshin punëtortë që kanë banu në këtë fabrikën e tekstileve, tjerrtorja që u qujke.

Aty kom pasë ni kusherinë për herë të parë kom shku atje mas ni mujve, dy mujve me pa atë me vizitu. Pastaj ajo m'ka çu te Hyrije Hana, ajo ka qenë në atë kohë në burg. Po me pa burrin e saj, çikën e sajna me ni djalë, dy djem i ka pasë baba i vet. Të Preshevës ata, Ali Aliu. Se shkojshin, se ka ndihmu shumë. Kur osht' vra Rifat Berisha në '49-ten i kanë përzan prej banesës ku kanë qenë dhe kanë dalë te xhamia në qendër që osht' ajo xhamia e vogël. Qaty me tesha e me krejt. Fëmi të vegjël edhe nana e grusë të Rifatit që ka qenë gjirokastrike prej Gjirokastrës, kurrë s'ka guxu as m'i ndihmu, as m'i marrë.

Ka shku Xhjije Hana, Hyrije Hana i kanë marrë, i kanë çu i kanë sistemu me ni vend ka Gërmia ku t'shkojsh do shtëpia, banesa ma të vogla kanë qenë ni kohë. Tani prej atyhit kanë kalu përfundi hamamit, gëlçere ku shitej përpara. Ni shtëpi dy katëshe ka qenë e vogël, ata kanë shku në Turqi dhe ka mbetë ajo qashtu shprazët. Aty kanë jetu ata. Domethonë i ka ndihmu se s'ka mujtë. Burri osht' vra ata çka kanë qenë në Berishë kanë qenë krejt të izolun, çka kanë qenë i madh mbi 16 vjet në burg, mashkuj, gra, vajza.

Njana ka qenë në Prizren në shkollën e vajzave. E kanë marrë prej Prizrenit, katër ditë e kanë mbajtë në Gllogovc në burg pastaj e kanë lëshu. Kanë burgosë ato që kanë qenë ma të mdhaja dhe ka qenë ni haus i madh. Sepse Rifati duke e parë që Kosova po mbetet në, nën Serbi, nën Jugosllavi nuk u bo ashtu si u mendu, si, ka qenë e folur edhe si të thom ni premtim. Normalisht se ai i forti gjithmonë i lun fjaltë e ban sipas vetit, ai që është ma i dobët s'ka çka bon.

Këta janë rritë. Besa grujen e Rifatit në mëngjes e kanë marrë në Beograd në burg e kanë çu gjashtë muj ditë. Ajo ka qenë shumë e smutë se e ka pasë tuberkulozin. Tuberkulozi atëherë ka qenë i pa shërueshëm. Kanë pasë shumë njerëz e s'kanë ditë e kanë qujtë lengim. Se gjatë ke vujt. Kështu që ajo e ka pasë dajtë në Amerikë, e kanë kërkua me shkue në Amerikë ka thanë, "Jo unë veç letrat du m'i bo me shku në Shqipëri për aty për kënd e ka dhanë jetën burri jem Rifat Berisha me gjithë vëllaznit e vet", '49-ten.

Gjashtë muj mbetet. Prej Beogradit e marrin e transferojnë në Vojvodinë. E smutë ma veç shpirti që i ka mbetë. E thirrin ni mjek edhe mjeku i sugjeron thotë, "Ka me ju mbetë në dorë, lëshone le të shkon në shpi se nuk e ka ma shumë se ni javë, dy edhe ka me vdekë". E lëshojnë, ajo qashtu me autobus mbrrinë në Kosovë, në Prishtinë. Kallxon vajza sajna, kur ka ardhë, veç ka thanë, "Lemni, du me shku në dhomë edhe kur të dal vet qatëherë". Katër ditë ka nejt në dhomë duke qajtë, duke përgatitë tani vetën se çka, si me jetu në fund e ka çelë derën edhe ka dalë edhe ma kush s'e ka pa me lot e sene. Po ka vazhdu jetën, u mundu m'i mbajtë fëmitë.

Djalin e madh, Muhamerin e kanë përjashtu prej shkollës edhe ai u dashtë me shit biletë në Kino Rininë atëherë e shoktë e vet t'klasës e shkolla e arsimtarë me ble ato biletë prej tij që ai me mujtë me mbajtë familjen. Atje në fshat në Berishë krejt të rrëthun, krejt të izolun që u dushke me çu ndihma e sene natën njerëzve për bukë e këto. Se s'guxonte kush me shku. Runin rojet, policia, ushtria, të gjithë. Qashtu edhe te na. Na ishim në Leletiq atje ku e blejtmë atë pjesë edhe gjithnjë kem pasë se dikush osht' t'u vëzhgu edhe kanë vëzhgu. Është dashtë thjeshtë m'u rujtë.

Nëse ke bo ma shumë punë e sene kah e boni këtë pasuni e sene. Po vërtetë kanë punu shumë, ka punu gjyshja, kanë punu djemtë barabar me ta. Krejt këtë pasuni e kanë që e kanë bo me durt e veta. Ni vëlla ma i vogël, axha ma i vogël, e ka menaxhu do të thotë punën e tokës e bagëtive e të gjitha këto. Kurse këta dy kanë punu në Minierën e Goleshit. Axha si administratë atëherë që shkonin, punonin me dur, me vaj me këto kanë qenë do sende, do pamuka që i fshin durtë e sene. Pastaj letra, pastaj blloka të ndryshëm, magacinë i kanë thanë. Ai e ka mirëmbajtë atë.

Në fund, erdhëm në Prishtinë domethonë për m'u shkollu dhe mendimi i prindërve ishte se ne do të kthehem me të gjithë prapë po secilin fëmi me shkollu edhe të axhës tjetër, e tjetër. Se ishte aty dëshira e prindërve edhe e babës, "Unë s'e kom kry shkollën po du ju me pasë jetën ma të mirë se unë, të gjithë". Ai punonte me neve fëmitë. Normalisht kur shkojshim në shkollë ka qenë vetëm ni ëmbëltore aty afër Goleshit, "Shkoni hani atje unë e paguj në fund". Na tani shkojshim me shoqni. A tomloriz, a ëmbëlsira, bakllava (qeshë). Kur shkojke me pagu, "Çka keni ba?" po na shkojshim me fëmitë e fshatit. E merrshim dajën tim ishte në shkollë. Thojke, "Unë s'kom hesap bash asi po pak ma ndryshe me punu" (qeshë).

## Pjesa e Dytë

**Mejreme Shema:** Kur kom ardhë në Prishtinë disi jom gjetë me shoqërinë, me vajzat, me këto. Kishim dëshirë me lexu edhe i gjejshim librat. Herë kësi, vitin e '60-të, '61. Skripte. Krejt i kemi lexu. E merrsha e gjojsha unë ni libër, ua jepsha shoqeve në klasë e lexojshin, gjatë mësimit. *Rrrrr* {onomotope} e kryjshin, e merrshin tjetrin. Në vitin 1962 unë e thom që ka fillu konsolidimi i kësaj lëvizje në krye me Adem Demaçin.

Pasi ka lindë vajza e parë, Abetarja, qatëherë kom shku në shtëpinë e Ademit. Më kanë pritë shumë mirë, më kanë respektu shumë. Jo vetëm Adem Demaçi po Xhemajlia, nana e Adem Demaçit po edhe familjartë e tjerë kushdo që vike. Kom pasë ni respekt të madh me të gjith. E re kam qenë po kom lexu shumë. Kom marrë libra, çdo të dytën ditë kom marrë libra te Ademi. I kom lexu, ia kom kthy. Kom thanë, "A muj me ju dhonë edhe shoqeve tjera?" "Po si jo, merri me i lexu me krejt".

E kom ndi ni knaqësi me t'vërtetë. Xhemajlia ka qenë ni mësuese shumë e devotshme, shumë gru e dhanun pas fëmiut, pas familjes. Kushtet i kanë pasë shumë të vështira. Ka qenë ni oborr i madh, ni kësi, dud i madh, ni shtëpi, do të thotë dy shkallë të vogla për me hy. Me thanën paradhomë nuk o' si koridor e me hi në dhoma. Ajo ka qenë pak ma e madhe, dritaret i ka pasë deri në tokë, ka pasë ni minder<sup>1</sup> edhe ni krevat hekurit dysh që ditën pushonte Ademi, natën e përdorte për me fjet. S'ka pasë ku tjetër.

Po megjithatë diqysh ka qenë ajo jetë e kandshme n'atë kuptimin se të gjithë nuk kanë qenë si ndasi t'mdhaja. Secilin e ke pa domethonë që diçka i ka mungu, diçka edhe nuk ke mujtë me thanë që hajt ky koka ma mirë ky asine. Po megjithatë Xhemajlia ka punu si msuse, sado kudo ka pasë ni mundësi pak asi. Kurse Ademi nuk ka punu. Ademi burgun e parë, mas burgut t'parë ai nuk ka punu asniherë domethënë.

**Anita Susuri:** E a ka qenë edhe dikush tjeter në rrethin e juj i organizun në atë kohë?

**Mejreme Shema:** Tash, kjo tash është me ni grup njerëzish. Pasi ka ardhën Adem Demaçi prej burgut të parë, '62-shi më duket osht' lëshu edhe '62-sha osht' domethonë me shokë me asi. T'u bisedu e sene ka fillu ni konsolidim. Hajde te bojmë ni organizim kush osht' për bashkimin e trojeve shqiptare. Njerëzit janë ofru, msus, student, nxanës, në përgjithësi. Edhe punëtorë të tjerë që e kanë pasë domethonë në shpirt bashkimin me trojet shqiptare sepse kurrë s'janë pajtu me atë që është bërë me Kosovën.

Në këtë frysë, në këtë formë domethonë është kriju kjo lëvizja për bashkimin e trojeve shqiptare. Është mendu që të shtrihet do të thotë në të gjitha kto qytetet kryesore të Kosovës. Ka arritë do të thotë në Pejë, në Gjakovë, në Mitrovicë, në Prishtinë ma shumë. Në disa vende të tjera po ka qenë në

---

<sup>1</sup> Dyshek kashte që shtrihet mbi tokë apo dërrasa.

konsolidim e sipër. Ende s'ka përfundu ai konsolidimi i saj, organizimi i saj që me mbajtë ni kuvend m'u zgjedhë organet e krejt. Po ka qenë ni grup iniciativë që i kanë udhëheqë këto.

Në fillim kanë qenë dy grupe për të rinjtë. Ka qenë Abdyl Lahu që është ai i Demaçit, Ademit, ka qenë edhe Ilmu, ni normalist. U dashtë tani me i bashku këto grupe, me i bashku. Kemi mbetë grupi, osht' marrë do të thotë Abdyli, në kryesi ka qenë Abdyli për të rinjtë. Ma vonë tani edhe unë për vajzat. E ato udhëzimet, ato, s'kemi mujtë me majtë mbledhje kumeditë çka se s'kemi pasë ku me majtë u dashtë te Ademi me shku. Ademi e ka pasë karshi policin që ka punu në burg. Domethonë s'ka pasë nevojë as me pasë lista, as s'ka pasë nevojë me nxan diçka e sene. Ka mujtë secilin me fotografu që kemi shku, na kemi shku. Tjetra...

**Anita Susuri:** E ka pasë fqinj?

**Mejreme Shema:** Urdhno?

**Anita Susuri:** Fqinj e ka pasë?

**Mejreme Shema:** Po fqinj. Tjetra, kur dilshim në korzo Ademi dilke me ahmet Haxhiun a me Azem Beqirin disa tjerë të partë, na krejt mas tij. Veç domethonë osht' ditë. Serbët i ke pasë anën tjetër na krejt mas Ademit në korzë. Tani secili shkojshim në shtëpi. Kështu po thom që ke mujtë me i mbajtë mbledhjet me thanë po i thirrim të gjithë po u dashtë me pasë si thojnë korir ose dikush me i shpërndat informataçt do të bahet, tek do të bahet.

Ka shkru shumë [Selatin Novosella](#) për këtë periudhë e sene po i ka deviju pak senet. Dikujt i ka dhanë përparësi dikond s'ka mujtë me marrë e sene edhe pak i ka deformu të dhanat. Se tash pak t'u i kërku disa gjëna po i gjoj që i kom që i kom dhanë për shembull për Abdyl Lahën. Unë e kom çu në Lupç, ai s'e përmend fare. Domethonë merr, jep ni formë tjetër. Thojsja unë kom harru a çka osht' kjo punë po kur i shoh dokumentat e shoh që hala i kom qysh i kom dhanë. Grupi i të rinjëve ka qenë bukur i madh. Disa i kemi njoftë disa s'i kemi njoftë. Ka qenë Ibrahim, babgjyshi, po ia harroj mbiemrin...

**Anita Susuri:** Gashi?

**Mejreme Shema:** Qysh?

**Anita Susuri:** Gashi?

**Mejreme Shema:** Po, Ibrahim Gashi. Ka qenë ni, o, Hoxha, emni qitash s'po më kujtohet. Shumë ni djale i mirë, punonte, e ka pasë kah Gërmia t'shkojsh shtëpinë me dyrë të mdhaja. E në treg shitke, ka qenë normalist. Pastaj kur u bo e dënu një ni muj a dy edhe ai shkoj tani me familje në Turqi, po u

kthy s'muji me ndeji, erdh. Po kurrë s'e kanë lanë me kry shkollën. Merre me mend rrobaqepës ka punu tani edhe ai ashtu.

Ka plot të tjerë që emrat nuk ia di e sene. Po janë burgosë shumë në atë periudhë. Aktivitetet e para janë kry në vitin 1963. Domethënë u mor' ni vendim që të dalim me disa aktivitete m'i shpërnda flamuj nëpër vende kryesore. Secili e ka pasë ni detyrë domethonë. Fazli Grajçevci<sup>2</sup> e ka qit' mbi Golesh, atje flamurin. Ilmiu normalist ka qenë, në Lipjan. Por s'e ka kry detyrën se s'ka mujtë m'i qit', jo kanë qenë polic e sene, ka mbetë. Tjertë kështu me radhë. Gjakova, atje, atje, gjithkund a din. U bo nifar' hallakam e madhe mirëpo kaloj pa ndonjë problem e sene.

**Anita Susuri:** A keni pasë ju ndonjë...

**Mejreme Shema:** Unë jo. Unë e kom ditë po unë u dashtë me qenë, me Ilmiun deri vonë që edhe m'u zanë me thanë që kemi qenë, kemi shëtitë se s'kemi bo na kurgjo, s'kemi qit' flamura. Po për fat ai s'muji me qit' në Lipjan.

**Anita Susuri:** E flamujt ku janë marrë?

**Mejreme Shema:** E flamujt i ka qepë, domethonë, n'këtë periudhë ky, Novosella, Sabri Novosella. Ai ka qenë rrobaqepës ai ka qepë flamuj. Janë shpërnda. Janë caktu njerëzit t'cilët m'i shpërnda. Jo Vushtrria, jo aty, jo në Prishtinë. Tash mbas ksaj periudhe kemi bo aksionin tjetër për me u preqatitë do të thotë prap me flamuj prap me kto.

Në mëngjes të '64-tes, a ka qenë tetë a nantë nuk e di, m'duket 8 qershor, qashtu ka qenë. Është marrë Adem Demaçi n'mëngjes, është marrë ni në Gjakovë, është marrë ni tjetër në Pejë edhe dikush nuk e di. Ky Ahmet Haxhiu nuk është dorëzu niherë. Disa të tjerë janë burgosë. Kurse Lahu, Abdyli, nuk ka qenë në banesë. Vjen në mramje dikur e mori vesh, na e morëm vesh, rrishim, po kqyrim çka po bohet.

M'thirrë motra e Ilmiut, Emine Rakovica, edhe ajo normaliste ka qenë. Bile ai vllau i vet nuk e dijke që është në grup tonin se prej Abdylit ka ardhë. M'thirrë m'thotë, "Hajde osht' Abdyli, ti, unë duhet me bo për shkak që janë burgosë çka me bo, t'marrim ni qëndrim edhe Abdyli po don mos m'u dorëzu me mujtë me dalë për Shqipëri a për ku", thashë, "Mirë". Shkum, mramje ishte. U ulëm, po bisedojmë. Ai kishte dy kufera me libra.

Tash kërkonte që dikush me përcjellë, me çu deri në Lupq. E kishte grujen e vllaut prej atjehit, qishtu diçka. Morëm vesh që me vazhdu aktivitetin, s'paku bile në Prishtinë. Me i qepë flamujt, me i qit' me

---

<sup>2</sup> Fazli Grajçevci (1935-1964) ishte një aktivist politik shqiptar, poet, intelektual dhe patriot i cili u bë i njohur si "simbol i flamurit" midis shqiptarëve gjatë viteve 1960 në Jugosllavi. Pas 14 ditësh torturimi, ai vdiq në burgun e Prishtinës më 17 gusht 1964.

këta rininë që janë që ende s'ishin burgosë edhe mos me mendu që u dorëzum edhe s'ka ma kërkush, u burgosën këta edhe s'ka ma mas ktyne.

Ashtu mbet edhe e gjetëm kush me i qepë flamujt. Elhame Shala. Edhe ajo ka qenë mjekësi në shkollë teme. Do të thotë bashkë kemi qenë në shkollë të mesme. E ka pasë te katër llullat i thojnë aty shtëpinë edhe ajo e murr' përsipër m'i qepë. Në atë kohë Ilmia ua ka dhanë ktyne të rive, kujt ia ka dhanë nuk e di, po ia lexova pak këtij Selatinit që thotë atje në Vushtrri e sene. Unë e di që s'kemi folë përvende tjera po s'paku bile në Prishtinë i kishim ma... që le të lëvizin.

Kush p'e çon tash Abdylin? Unë thashë, "E çoj", "Jo asine nashta", thashë, "Jo". Ajo Eminja ka qenë pak e smutë, ka qenë në spital. Thashë, "Jo, unë e çoj". E kom marrë e kemi shku jo rrugës kryesore po kah mulliri i Bankoviqit, Rruga e Llapit e në atë anë e kemi dalë te shpija. Fjet kanë qenë tjertë. Nana vetëm, "Çu dil në kuzhin flej", "Kuku kush osht"? Çka na bone?" Thashë, "Osht' daja i Adem Demaçit", thashë, "edhe ka me përcjellë me çu deri në ni vend. Kur vjen baba i kallxon kujt tjetër mos i kallxo".

Ia marrë mantilin, shamijen, dimijat e sajna veshna. Kah ora katër a pesë nuk e di, treni shkonte për Podujevë. Aty e pritshin... derisa e pritshim trenin dikush na u ka ofru se e kanë kérku këta, e kanë kérku në Podujevë në shpi t'vet atje ku osht'. Se te Ademi s'o. Ky thotë, "Po shkoj me çu nusen e vëllaut n'familje në Lupq", a ke në Lupq? Kadal, jo në Lupq po në Koliq, m'fal, në Koliq. Qe a p'e sheh mirë që asi se në Koliq se në Lupq këta të Lupqit kanë qenë. Në Koliq. Ka qenë ni vend goxha n'kamë me shku e mal e sene.

Aty na priti n'odë plaku i asaj shpije. I tregoj Abdyli që qishtu qishtu, "U burgosë Ademi, i kanë burgosë disa tjerë. Unë s'po du m'u dorëzu po du me kqyrë me dalë për Shqipni", "Po këto libra këto sene ku don m'i çu?" Diçka me bo me to, a m'i marrë a, kumeditë njeri në ato momente nuk osht' tepër i kfjellt me menu se ku e çka, po i ka marrë me veti mos m'u gjetë.

Hongrëm bukë, mëngjes. Unë shkova te gratë me pushu pak derisa vishin djemptë e tina që me bisedu çka me bo, qysh me çu, qysh me hjekë prej këtu. Kurse unë njëri djalë i tij me m'çu deri te treni edhe unë me hypë në tren me ardhë për Prishtinë. Mendoja me ardhë normalisht kurgjo s'ka ndodhë. Ndërkohë veç kur ka mrri gazika. Domethonë ai sinjal meniherë në Koliq. Ibra Haskaj si hetues, ni tjetër hetues që ka qenë pastaj edhe hetues i jem, ni i trashë, tybe e disha qysh e ka pasë emrin, veç m'i ka dhanë nja dy shuplaka të mira që sot i mbaj mend edhe shoferi.

Ata e kishin lidhë Abdylin, durtë edhe plakun përpara, "Hajde tash me kallxu kush osht' ajo nusja që ka ardhë me Abdylin, a osht' reja jote?" I shkreti çka me thanë, kujna m'i thanë, as s'e kishim bisedu as kurgjo hiç. Kahre i bom edhe këta. Po i dëgjoj, si kanë hi brenda, "Cila osht'?" Ato gratë tonat {rrudh krahët} secila kryt te poshtë e sene. E kom çelë derën thom, "Unë jom", "Kush je ti?" Thashë, "Qajo që p'e kérkon" (qeshë).

Ai p'e vet tash plakun, "A osht' kjo nusja juve?" Ai {rrudh krahët}. Thashë, "Jo jo nuk osht' kjo nusja tina", thashë, "po unë kom ardhë e kom pru Abdylin ka ardhë me marrë nusen a çka nuk e di po kom ardhë me to, kom pasë dëshirë me pa Podujevën s'e kom pa asnisherë", kështu e lidha. Na kanë hypë në gazikë kemi ardhë.

Bile bash te rruga prej urës prej Podujevës që t'bjen ka pasë gëlqere qaty shitej edhe qaty ata t'u folë, t'u bo hajgare diçka. Thashë, "Le se kur u bo magjupi mbret e ka mytë babën e vet", a din, "A mu po m'thu magjup a?" Po don m'u çu me m'i lidh durtë. thashë, "Ti durtë lidhmi po gojën s'mun ma lidhë". Foli diçka Abdyli atij ia dha dy grushta. Kemi shku në SUP [Ministria e Punëve të Brendshme] s'jemi pa ma. Ai tjetër kush e ka marrë, mu tjetër kush.

Kom nejtë ni orë a dy qaty me ni daktilografe çka di unë. Ajo kryjke punën e vet e krejt. Derisa kur kom fillu me dhanë kush jom e tek jom e sene. Kur kom fillu m'i dhanë të dhanat e mia jom filanja, e Komunës të Lipjanit, bija e Liman Berishës e kështu e kështu. Ata janë shku e kanë thirrë Saba Sutatoviqin. Ai ka qenë për rrethin e Lipjanit përgjegjës, domethonë për politikë e për këto sene. Veç e ka qelë derën "*Čija si ti?* [srbsk.: E kujna je ti?]" thashë, "Liman Berishës", "*Nemoguće, ona ide u školu* [srbsk.: E pamundur, ajo shkon në shkollë]" thash "*Pa i ja idem u školu* (qeshë). Edhe unë shkoj n'shkollë".

Veç e kom hjekë shaminë, e kom heq mantillin, e kisha blluzen ngjyrë hinit, se vera ishte, qershori. Dimijat, sandallet, fundin e kisha përfundi. Thashë, "Qe, a jam e shkollës?" (qeshë). A ka qenë njëmbëdhjetë a dymbëdhjetë tybe s'di se orë s'kom pasë po derisa e bon as s'kemi hongër drekë as sen hiç, qat' mëngjes në Koliq. Në pytje, po. S'na kanë bashku a din që me thanë. Çka ka thanë, unë nuk di. Bash pram e kom mendu tash janë ato në arkiv e me shku me pa qysh osht' mbrojtë e çka ka folë po nuk e di.

Unë atë verzionin tem, "Vallahi u mërzita në shpi, shkollën e kena kry më thirri Abdyli, "A po vjen se po shkoj deri në Lupq?" Edhe kështu unë shkova me të", "Po a?" "Qishtu, tjetër gjë nuk di kurgjë. As nuk di çka ka në kufer hiç", "Ani mirë". Jo që ka besu po tash s'kishin fort edhe a din hala s'i kisha 18 vjet. E thirrin tash babën. Baba para se me shku në SUP thotë, "Kadal te di niherë në shpi çka u bo se s'pe di. Kur shkon nana i kallxon thotë qishtu, qishtu, "Valla s'ka ardhë prej qasaj ditës që e ka çu dajën e Ademit ni katun nuk e di. Veç e dijmë që është në burg", thotë, "E po mu më kanë thirrë për qata".

Vjen tani baba i thojnë, "A din që..." thotë, "Jo valla prej juve po ni", s'kallxon hiç që u kanë në shpi. Thotë, "Prej juve qitash po ni se drejt prej punës e këtu erdha", thotë, "Jo qishtu e kena zënë me njënin është ai Abdyl Laha është daja i Adem Demaçit. A e njeh ti Adem Demaçin?" "Kom ni po nuk e njoh se nuk kom taku me ta, nuk e di", "Vajza jote është gjetë aty", "Valla unë qitash po ni. Unë kom menu", thotë, "mos ka ikë për naj djalë a për naj kond a diçka që s'ja kisha dalë se s'e kom ditë për këtë punë", "Tash p'e din ti bonu kujdestar i çikës tane, na nuk t'bohem. Ti ki kujdes".

Më merr baba mu shkojmë në shpi. Bisedat e këto. Tani meniherë mas dy-tri dite duhet me bo aktivitet, duhet me tregu që nuk kanë qenë veç ata po ka edhe tjerë. U morën vesh me kta t'ritë me i qit' flamujt. Unë e di për Prishtinë për që është qit' në Vushtrri e tjera nuk e di. Ndoshta edhe kom harru se osht' kohë e gjatë. Po e di që për Prishtinë janë përgatitë. Ka mbledhë. Ilmiu ka mbledhë këto materialet, i ka çu m'i kepë te Elhamja. "Ku?" Thashë, "Te Elhamja çojmë se Elhamja din me kepë". Punojke pak me rrobaqepësi.

I ka qepë Elhamja. I kanë shpërnda tani Ibrahim Gashi, ky Hoxha, o' bre si e pat' emrin po ia harroj. Shumë djale i mirë, njifet edhe me Ibrahimin e krejt, normalist ka qenë. Sigurisht Selatini nashta, Selatin Novosella, bashkë i kanë shpërnda ato. Kanë dalë herën e parë kanë dalë, u kuq si thojnë aty këtu. Në rrugën "Xhavit Mitrovica" nja tre-katër. Në do vene kështu ma kryesore veç u shpërndan.

Po u kapën meniherë. Veç nëpër shtëpia *trap* {onomotope}. Elhame Shala, Ibrahim, ky Hoxha e plot do tjerë a dinë. Se qysh tek nuk e di. Po qata që kanë qenë qata u morën edhe u dënun dikush tre muj dikush dy muj dikush ni muj. Na apet metëm unë, Ilmiu, Eminja edhe ky Hoxha mbet. E tash unë e mora atë udhëheqjen e grupit (qeshë). Thashë, "Apet do t'vazhdojna, deri nesër në 13:00 po vazhdojmë". I kemi marrë flamujt, i kemi qepë. Unë mendoj se Ilmiu i ka çu po m'doket te kjo Muqolli, Adile Muqolli se ka qenë edhe shoqe e Elhames edhe ajo merrej me rrobaqepësi. Ajo i njifte se ka qenë e Prishtinës, i njifke. Ajo nuk është dënu.

Në mëngjes hala pa dalë m'i qit' se unë në mëngjes herët ia kom çu Hoxhës me korpë flamujt. Në mëngjes i kanë zanë. S'kanë mujtë m'i qit', i kanë marrë qashtu të qepur, i kanë dënu. Edhe këtë Hoxhën dy muj tjertë ma ishin dënu ma herët mbeta veç unë. S'kisha kah me shku (qeshë). Çka me bo, tek me bo. Tash këtë Fazli Grajçevci ende s'e kishin burgosë. Fazliu nuk ka qenë aty ka qenë ma shumë në Prishtinë, punojke. E takoj unë bash te gjyqji. Se qaty e ka pasë rrugën te shkolla e "Emin Durakut" banjke me grujen.

Thom, "More Fazli", qishtu qishtu, "a e din", thotë, "Po bre edhe mu", thotë, "m'kanë lyp në katun atje e m'kanë lypë këtu në shpi", thotë, "po s'më kanë gjetë, s'di çka me bo e sene", thashë, "Ani masi koke edhe ti edhe une, hajde ti e njeh dikond une dikond a po vazhdojmë", thashë, "qishtu kena vazhdu. Po janë zanë të gjithë", thashë, "në qoftëse dojna me tregu që vazhdon puna po vazhdojmë", thotë, "Ani une po shkoj deri në shpi e takohemi në fshat te une në Zabel". E kishim Zabelin afër. "E takohemi e kur të vi në Prishtinë bisedojmë", thashë, "Ani".

Ai shkon në fshat vet ndërkohë vjen ku e kemi lonë venin. U takum edhe tham, "Ani takohemi në Prishtinë", edhe po bisedojmë çka me bo tek me bo. Jam nisë me pritë përmi lum aty ura ka qenë. Prit s'ka, prit s'ka, prit s'ka hiç. Jom nisë tani për shpi në banesë ku ka banu te Shkolla e "Emin Durakut". E gjoj atë grujen e vet t'u kukat. "Çka u ba?" Thotë, "Jo, e kanë marrë sot në mëngjes edhe Fazliun", thashë, "Hajl i koftë, s'kena çka me bo tanë i kanë marrë na marrin".

Ai tani e kanë mundu shumë, goxha shumë e kanë mundu edhe asine, vdes në burg vdes. Ka qenë tepër sene... u shukat pastaj ajo punë e sene po u ditë, u ditë njerëzit që u dashtë me çu në spital m'u caktu vdekja e krejt. Po prej të rrahunave e mundimeve e sene ka vdekë...

**Anita Susuri:** Qysh e keni pritë ju...

**Mejreme Shema:** Urdhno?

**Anita Susuri:** Qysh e keni pritë ju këtë lajm kur keni ni që...

**Mejreme Shema:** Shumë keq, mbeta veç vet. Domethonë krejt çka i njifsha unë ma s'kisha kond, a din. Çka me bo, kurgjo atëherë pushum. Ndërkohë pritshim me dalë në gjyq kah shtatori, në fund të gushtit besa ka fillu gjyqji. Kanë dalë ni grup i Adem Demaçit e do tjerë e sene. Qysh ka shku tek ka shku gjyqji nuk e di se neve na morën pa fillu gjyqji. Shazije Gërguri ishte shoqja jonë, Eminen e morën edhe erdhën më morën mu. Thashë, çka u bo a din? Kur po m'shtijnë në atë kerrin e policisë qe Shasija qe Eminja. Thashë, "Ku jeni t'u shku more?" Thanë, qishtu qishtu, thashë, "Hajde hajl i koftë", thashë, "na pret Elhamja atje në burg", ajo ish hala e dënune a din.

Shkum na hajgare, çka u bo kështu e sene. U mërzitshin se ajo Eminja s'e kishte provu kurrë. Unë e kisha provu edhe e disha qysh osht' tek osht' edhe Shazija e ka pasë vëllaun në burg po vet s'e ka provu a din qysh. Ma s'pari nana e Shazijes erdh me jorgan e se prej përvojes që kanë pasë njerëzit në burg. Nana Eminës qashtu edhe ajo çorapa se e dobët Eminja e sene. Thashë, "O lumet ju për këto nanat e juve", (qeshë). Nana jeme molla, dardha, pemë. Ka pasë qef me hangër. Ni krojshe na pruni, "Mirë edhe këta e kryjtëm nga ti".

As dishim për çka na kanë marrë, as s'na merrshin në pytje as kurgjo. Bojshim hajgare me Elhamën. Bile ia lexova vendimin e saj, a din, krejt që me m'pytë e di çka qysh tek. Masi u kry gjyqji na kanë lëshu. Ka njo ka njo. Thashë, "Qyre, le diçka te di bile që je dalë", secila a din. Mu t'mramen. Kah 10:00 i natës qashtu m'kanë lëshu. E shkova në shpi. Pse na kanë marrë janë frikësu që mos po bojmë naj preqatitje në gjyq e sene edhe me pasë pak nifar' izolimi. Po gjyqji si gjyqji nuk osht' majtë si thojnë mirë, s'janë majtë disa njerëz mirë, a din. Kanë mendu se nuk duhet m'u burgosë e nuk duhet... dasmë pa mish nuk ka, thojnë. Po secili n'atë mënyrën e vet jo unë kom qenë, jo unë s'kom qenë. Nifar' ankesa e sene.

E ke pasë si udhëheqës Ademin e tash pse m'u anku? E ke pranu. A osht' qashtu? Veç nuk më kanë pëlqy disa biseda, disa fjalë do të thotë gjatë gjyqjit. Po u kry, na kanë lëshu me shku në shpi. Kemi shku në shpi edhe ma nuk ka pasë aktivitet fare. U dënun. Dikush me 15 vjet, dikush me dhjetë vjet, dikush me katër vjet e qishtu me radhë. Po bukur shumë njerëz janë burgosë edhe janë dënu bukur shumë. Përfundoj kjo, Xhemajlia mbetë me dy fmitë, Abetaren do të thotë që i kishte hala katër vjet

nuk di, Shqiptari hala s'kish lindë. Tek në burg mas burgut, domethonë, nuk e di cilin veç ‘64-ten nëntor a...

**Latra Demaçi:** ‘65.

**Mejreme Shema:** ‘65-ten po, domethonë ka lindë. Që Ademi s'e ka pa domethonë deri që e kanë lëshu prej burgut. Osht' rritë djali. E tash unë kom qenë shumë edhe sa ka qenë Ademi edhe nana e Ademit unë kom shku, kom hi, kom dalë si në familje teme. Po edhe pasi u burgos kom shku te Xhemajlia edhe te nana e Ademit, kom nejtë, ju kom, ka pasë nevojë diçka diçka e sene gjithmonë e kom përkrahë. Edhe familja jeme, nana, baba, vllaznit kështu të gjithë. Diçka m'u bo, “Xhemajli, kqyr se m'u bo naj sen fëmitë”, ata ishin të vogjël po pika e parë ishte që qata t'i m'i mbrojtë, mos me pasë diçka të keqe e sene.

Derisa ka vdekë nana e Ademit ka qenë mirë, domethonë s'ka pasë probleme, me qito halle me qito... hala kanë qenë në Prishtinë, hala s'i kanë çu domethonë jo në Pozhorevc e jo dikund ku i çojnë masanej ato. Pasi ka vdekë nana e Ademit, fillun do probleme ai e çoj letrën që “Po du m'u nda me Xhemajlien, nuk osht' gruja ime”. Me t'thanë të drejtën tanë e pritëm keq edhe populli e ka prit keq. Se diqysh u mishëru. Tani ai osht' në burg po kjo është n'shipi, osht' me fëmi edhe ni burg ma i vështirë këta e pret, puna të gjitha këto. Qashtu ishte. Ishte mësu se e bon pastruse.

Vraponte me shku me nxan punën në autobus, tamon mrrinte te autobusi shoferi ia mshelke derën, u dashke me ecë në kamë me shku gati te Vushtrria dikund ku jepke mësim. E ma vonë pastrojke e sene. Po shko mos e lësho punën, deri t'përjashtojnë vet ti mos e lësho. Ata nuk e përjashtunën po ia ndrrun vendin e punës. Nuk e lanë msuse, pastruse e këto. “Unë s'disha kah çka bon burri jem, unë i kom pasë fëmitë e mi i kom kqyrë, i kom, jom mundu me majtë familje, ajo osht' puna e tij. E keni dënu në rregull”. Po pastaj do gjana, do sene fillun edhe destabilizimet edhe në përgjithësi në Kosovë.

Kjo periudha ‘64-tes e hapi ni kapitull tjetër. Vërtetë pati ni jehonë të madhe edhe u dënum. Se jo për shkak tonin po për shkak në përgjithësi në Jugosllavi. U dënum disa njerëz që i kanë kapërcy detyrat e veta me kësi rrahje e dëname e asi. Këtu u largu ky Ibra Haskaj edhe nuk e di edhe dikush tjetër. Diku në Gjakovë ni pastrues i shkollës, nuk e di. Po jo kumeditë çka e sene, nuk e di. Mirëpo filloj do të thotë ni bisedë, ni debat lidhur me çështjen e Kosovës në përgjithësi edhe në kuadër të shtetit, domethonë të krahinës. Se ishim si krahinë po si autonomi si diçka që s'kishte do të thotë emër me folë vet a diçka.

Po megjithatë ishin Rrezak Shala plot disa të tjera që i morën do të thotë m'i vërtetu gabimet e ish Jugosllavisë edhe Jugosllavisë pas luftës që mas luftës me shqiptarët është marrë do të thotë sikur me qenë qytetar të rendit të dytë a të tretë. Jo si qytetar të cilët kanë kontribu edhe në luftë edhe në bashkëjetesë e gjitha këto. Kaloj kjo edhe u ardhë ni periudhë edhe tash u dashke me u bo kushtetuta. Për herë të parë me pasë ni kushtetutë Kosova edhe me ba kushtetutën juristët me disa arsimtar. Shkolla e fakultete nuk kishte kumeditë sa.

Ishë Fakulteti Filologjik, ishin disa degë të Fakultetit Filologjik të frangjishtës, të anglishtës e t'gjuhës e letërsisë shqipe kshtu me radhë. Po nuk kishte shumë studentë atëherë, ma pak. Kishte edhe nxanës në shkolla t'mesme pak. Normalja ka qenë ni shkollë si t'themë fakultet për t'gjithë. Se aty u përgatitshin kuadrat për me msu nxanësin, pedagog t'mirë e t'gjithë. Derisa ka qenë normalja vërtetë ka qenë msimi shumë i... për nxanës e për krejt. Janë ato kuadrat që me t'vërtetë kanë dhanë kontributin e vet në t'gjitha fushat ma vonë të Kosovës. Qoftë në luftë, qoftë në forma të tjera në konsolidim të fakulteteve e tjera, e tjera. Hapjen e universitetit. Se nuk e bon ni njeri po e bon grup njerëzish të cilët janë marrë pastaj.

Kanë bo kushtetutën edhe në bazë të kushtetutësështë bo pastaj, si t'themë, ni pjesë konsituive e federatave jugosllave. Gati ka qenë si federatë, vetëm s'e ka pasë emrin. E pse e kanë lanë serbët me bo këtë,është puna e atyne. Çka kanë pasë me të me kujtu me ba... se interesë ka qenë qysh prej luftës, përfundimit të Luftës së Dytë me bashku Shqipërinë me federatat jugosllave. Këtu ka qenë ajo periudha që janë marrë njerëzit Xoxa, e do tjerë që kanë qenë do të thotë bashkë me njerëzit jugosllav.

Aspirata e tyre ka qenë do të thotë me bashku Shqipërinë me federatat jugosllave. Qiky ka qenë me dalë në bregdet atje. Mirëpo ajo nuk u ba. Tash kush osht' fajtori e kush osht' fat që s'e ka lanë m'u bo osht' në rregull shumë mirë. Po tash na kishim ni, me thanë, nëse nuk punon për shtetin e për atdheun i kishe puntë mirë. E kryjshe ni punë e sene nuk t'preke kërkush po po u përzive në politikë atëherë t'honke dreqi. Ose shkojshë në burg, ose ishe i izolun ose diçka gjithmonë. Çka do që u bojke në atë periudhë dikush i thejke vorret serbe e çka vishin më merrshin mu. Thashë, "More nuk jom unë, çka më duhet mu m'i thy vorret e serbëve".

## Pjesa e Tretë

**Anita Susuri:** Para krejt kësaj domethonë kur ju izolun...

**Mejreme Shema:** Po.

**Anita Susuri:** Ju e keni përfundu shkollën...

**Mejreme Shema:** Shkollën e kom përfundu unë qat' periudhë. Domethonë kom pasë veç me mbrojtë temën e diplomës se përfundoj mësimi edhe tash kishim praktikën. Edhe praktikën e kreva në spital edhe tash pritshim me mbrojtë temën e diplomës. Ndërkohë unë ni javë ditë nuk po m'cojnë ma shumë në burg herën e parë, u lëshova. Në qat' kohë u mbajshin provimet e diplomës. Unë hina normalisht kërkush kurgjo s'më ka thanë.

Tamon jom hi edhe jom dalë para arsimtarëve, komisionit me mbrojtë temën, ka qenë Xhemajl Ahmeti gjinekolog, ka qenë Gazmend Shaqiri kirurg, ka qenë i fizikës ky Zeka. Vjen drejtoresha edhe po iu shushurit diçka në vesh. Domethonë e kanë lajmëru që mos me m'lonë me diplomu e sene. Ai Gazmendi tha, "A din çka, ajo ka dalë osht' t'u e mbrojtë temën, u dashtë me na tregu ma herët. Vazhdo". Kom vazhdu e kom kry, kom dalë. Si bursiste e Lipjanit m'u dashtë me shku m'u lajmëru në Lipjan me punu.

Kom punu ni muj e gjys, mas ni muj e gjys m'kanë suspendu se nuk kom pranu kurgjo që kom qenë në lëvizje as kurgjo hiç, a din. "Mirë pra, s'po pranon kurgjo atëherë suspendohu". M'kanë suspendu. Ndërkohë m'u dashtë me bo ankesa se osht' qysh me thanë ni obligim që mos me thanë s'ke bo ankesën e çka me t'bo. Po u dashtë me bo ankesën, e kom bo ankesën. Mirë m'kanë pritë, mirë kom punu ni muj e gjys. Po domethonë edhe drejtori që ka qenë serb, "Më vjen shumë keq, po nuk është prej neve është prej njerëzve ma të naltë", thashë, "Mirë, e kuptoj".

Ndërkohë, u ktheva në shpi, mbeta në shtëpi. Shkojsha nganjiherë te Xhemajlia, vijshin, si dojshin. '65-ten në mars jom pranu në spital. Jom pranu në spital kom fillu me punu në repartin e lëkurës, dermatologjisë. Javën e parë si kom fillu mas ni jave ai i administratës, serb ka qenë, njo i shnosh, ia kom harru emrin. Po më thotë, "*Da nisi bila ti u zatvor?* [srb.: Mos ke qenë ti në burg?]" thashë, "Jo bre, nisam bila ja [srb.: Nuk kam qenë]" (qeshë) tha, "*Pa tako čujem ja ovde, reci mene* [srb.: Ashtu kam dëgjuar këtu, më trago ti mua]", thashë, "Vallahi çka di, a i ki dokumentat? Po. A shkrun? Jo. Edhe çka?" "Në rregull".

Kërkojsha, dojsha me regjistru anglishten me studiue. Çka me bo? U dashke ni vërtetim se s'mujsha e rregullt me shku e pa qenë e rregullt tani nuk t'jepshin këto nënshkrimet e tjera. Nuk ma dhanë. "Jo çka po t'vyn ty me studiu anglishten, boll e ki puno qitu"...

**Anita Susuri:** Deshta me ju pytë, qajo ni javë në burg, keni qenë në Prishtinë...

**Mejreme Shema:** Po.

**Anita Susuri:** Në Burgun e Prishtinës?

**Mejreme Shema:** Po, po në Burgun e Prishtinës.

**Anita Susuri:** Qysh kanë qenë kushtet për shembull?

**Mejreme Shema:** Tash qe po t'kallxoj. Tash sikur me pasë hyrja, qitu ka qenë hyrja që kanë qenë ato rrugës kryesore, kanë qenë këta të administratës, policisë e ajo çka ka qenë ministri e punëve të brendshme e krejt. Hymjen e ka pasë t'lidhne me burgun domethonë aty. Prej aty veç e bojke zilen i thojke politit, "Bire filanen në informatë me bisedu". Ka qenë ni dhomën dy me dy a s'e di çka. Atëherë

s'ka pasë as kreveta, ka qenë vetëm ni dyshek, ka pasë ni korit m'i la sytë. Nifar' s'e di çka me thanë qypi, s'di, ka qenë mizerie.

Pak ma vonë na çojshin m'i la sytë, ka pasë në koridor aty. E rend kanë qenë ato me disa herë do të thotë, me dry. Në mëngjes i qelshin për m'u çu. Tani me hangër mëngjesin, tani nëse t'thirrke dikush me shku në pytje e sene tap, rram, bam {onomotope}. Gjithmonë bojshin nifar' zhurme. Tani deri bijshin të marrke polici t'çojke aty në qeli e sene. Qishtu. Rend kanë qenë, kushtet s'kanë qenë të mira. Poshtë ka qenë, aty kanë qenë qeliat me beton, naltë kanë qenë pak me drrasa fjetje e sene. Poshtë kanë qenë kësi me beton qeliat edhe të errëta kanë qenë. Nëse bojshe faj ose diçka t'çojshin me nejt një dy-tri orë a dy ditë a tri ditë a.

**Anita Susuri:** A ju kanë leju naj vizitë? Prindtë a ju kanë ardhë?

**Mejreme Shema:** Çka me bo?

**Anita Susuri:** Vizitë për shembull prindt?

**Mejreme Shema:** Jo, jo çfartë.

**Anita Susuri:** Kur keni dalë prej qasaj domethonë n'qat' periudhë prej burgut që keni qenë, në familje si ju kanë pritë ose në rrëthim e juj?

**Mejreme Shema:** Në familje m'kanë pritë mirë se ata e kanë ditë, ata nuk ka pasë problem e sene. Bile baba kur shkonte që vinte i thonte nanës, "Kqyre leja paret se u msu me pasë. Leja paret le t'blen diçka mos t'ia zgjatë dorën dikujt". Gjithmonë... kështu që nuk kom pasë problem. Sa jom kanë n'shkollë e kom pasë bursën tani edhe kshtu baba m'lente për xhepa e sene, e kështu.

**Anita Susuri:** Po du tash me ju pytë për demostrata...

**Mejreme Shema:** Tash, vetëm desha t'them që populli nuk ka qenë shumë agil në këtë periudhë. Sepse ka qenë disi si i mashtrun. Dikush ka pasë punën e sene, i ka pasë puntë mirë. "Çka po lypin, Tita na ka dhanë tana të drejtat çka po lypin këta, çka po bojnë", ka qenë nifar' faze, a dinë, e tillë. Mirëpo kadal kadal duke u vetëdijësuar edhe për shkollë edhe për asi, fillun m'i çu fëmitë në shkollë, vajzat në shkollë e krejt do të thotë ndryshoj situata shumë për të mirë.

Prandaj e marrshin në mbrojtje edhe Xhemajlinë. Populli thojshin qysh me lëshu Ademi grujen? Ajo po i rritë dy fëmi, ku ka me shku në këto kushte, në këto rrëthana a din? E mbrojshin. E vëtmja unë prej ktyne që non stop kom qenë me to. Kur ka ardhë Adem Demaçi në fillim s'më ka folë se unë kom qenë me Xhemajlien edhe të takojsha Xhemajlien. Ai vijke, e kanë pasë ni fllanik derisa u maru ajo shtëpia e

re me iniciativën e Selatinit. Por populli ka dhanë mjete e këto. Po Ademi s'ka qenë fort, nuk dojke me hy, "Jo nuk du. Qysh ka qenë shtëpia jeme qashtu du". Po diqysh u morëm vesh e sene.

Bile kaniherë e ngucsha Xhemajlien thojsha, "Oj Xhemajlie qysh bre po i thu ato fjalë?" Po çka me bo po m'shtijnë me folë", "Ani mirë në rregull". Po a din, gjithmonë ka pasë nifar' jo po kështu jo ashtu, jo ashtu. Bile kur ka dalë herën e fundit Ademi, shkum me pa krejt e sene. Unë s'shkova i kisha fmitë. Shkum me vëllaun e me babën. Xhemajlia na boni e sene n'ata thirri Dallduri, "Oj Xhemajlie", "Boll qishtu", e sene, "Vallahi t'u ka bo si vjehërr", "Po po na ndihmon e sene". Baba jem, "Valla bre Adem krejt po t'i fali, veç qita s'muj me ta falë", se ai e njifke ish i Zabelit, i Drenicës, "çka po t'lidh", thojke, "me këtë Dalldurin ty?" "A bre baca Liman unë ata njerëzit që kom qef m'i përpunu m'i bo t'mirë..." a din...

**Anita Susuri:** E kush osht' ai Dallduri?

**Mejreme Shema:** Ju ka ndihmu shumë Ademi ju ka gjind e sene po ka qenë si t'thembi, bashkëpunëtor. Ai thojke, "Këta njerëz kom qef m'i ndihmu m'i bo t'mirë", "Ani ani ishalla osht' qashtu ia bojke".

**Anita Susuri:** E zonja Mejreme, po du me folë pak për demonstratat e '68-tes, a ju kujtohen juve?

**Mejreme Shema:** Po, po qysh jo. Demonstratat m'kujtohen. Kjo lidhet domethonë edhe me vitin '64 u bo ni jehonë, u bon disa punime disa gjana disa lëshime e sene. Disa i lejun me vazhdu mësimin, disa jo. Tash varësish qysh janë gjind e sene. Duke u marrë me ndryshimin e kushtetutës e të gjitha këto, duhej të kërkohej universiteti, duhej të kërkohen disa gjëra. Gjuha të jetë gjuhë e parë jo vetëm serbisht. Në fakultet i kishim gati landtë serbisht. U bo nifar' ndryshimi edhe u bo nifar' përpjekje domethonë me ba diçka. Pa ba diçka, pa lëvizë kërkush nuk merret me ty.

U bo me lypë Kosova Republikë. Kush me lypë? Nga Lidhja Socialiste e Komuniste Fadil Hoxha u mundu me kryetar të komunave po nuk boni kurgjo. Tha, "Lene këtë punë, s'bon kurqysh". U shukat. Përveç të Kaçanikut, kryetarit të Kaçanikut, Sali Bajrës edhe Halil Halili në Gllogovc. Ata nuk lëshun pe thanë, "Jo na kena me vazhdu". Sali ka dhanë kontribut të madh si kryetar komune. Bursa femrave për me shku në shkollë t'mesme, djemve krejt. Plot gjana i ka ba domethonë si me qenë republikë në veti a din. Ka pasë nifar' fuqie, s'di me thanë nifar' force edhe ky Halil Halili.

Po megjithatë e thyn Halil Halilin edhe u dorëzu. Kurse ky shkun krejt Komiteti i Kosovës me shkarku niherë prej Lidhjes Socialiste prej partisë tani me shkarku prej punës. Kaçaniku krejt shqiptarë, kush me shkarku, shqiptarë e shkarkun. E lanë, s'u morën ma me ta. Ai s'ishte ma kryetar e sene. Dikush e ka shkru ni libër për ta. Ma vonë e kom taku edhe vajzën e tij me ni rast vdekje diku kur më tha, "Jom vajza e Sali Bajrës", "U", thashë, "mirë boll".

E po du me thanë krejt këto ngjarje këtu u lidhën. E tash çka u bo? Nuk u bo në këtë mënyrë, u dashke me përgatitë nifar' mënyre popullin, nxanësit, studentët. Student s'kishte pak kishte, po ma shumë kishte në shkolla t'mesme. Normalja ishte, si t' themi kryesorja që kishte shumë. Tani ishte gjimnazi. Në gjimnaz nuk kanë shku me u... se kanë qenë ma shumë fmitë e ktyne bugjovanave [të pasurëve], domethonë njerëzve që kanë qenë në pozitë. Po megjithatë ata në mënyrë individuale kanë dalë. Nuk kanë qenë të organizun po në mënyrë individuale ka pasë plot që kanë dalë.

Ma së pari ka dalë djali i axhës që ka qenë në gjimnaz, ai tjetri, ai tjetri. Janë prebatitë. Drejtorët e shkollave të gjithë e kanë ditë që do t'bohen demonstratat. Bile mixha jem thojke, "Çfarë demonstrat janë këto kur fëmija në djep po i dijnë", thojke, "senet kur bohen kundra shtetit s'i din dikush, rrallë duhet m'i ditë", thosha, "E kanë bo qishtu p'e dijnë krejt". Tash krejt punojshim. Vëllau jem punojke prej Normales atje, na anën tjetër. Asnjani s'thojshim që po punojmë. "Ja kurgjo s'jena t'u bo", "Çka po bon ti?" "Kurgjo edhe unë qatje në shkollë po bojmë diçka". Asnjani me thanë që jom angazhu diçka, jo.

Atë ditë kur kanë fillu domethonë protesta edhe këto demonstratat, Normale ni javë ditë dy javë ditë kanë shkru parolla profesorat qaty kanë qenë i kanë lanë i kanë bo gati krejt. Pesë minuta në katër u dashtë me dalë para Këshillit Ekzekutiv domethonë tash që është parlamenti. Kanë ardhë. Dikush, "Ku po shkon?" "Po shkojna me lujt me top, me, kështu", t'u u mbledhë, t'u u mbledhë. Pastaj vetëdijësimi u bo edhe i popullatës. Prindërit erdhën anash rrishin me mbrojtë nifar' mënyre. Fillimi shkoj mirë, nuk pat', domethonë, kështu ngacmime diçka.

Filloj tani t'u shku tani rrugës do të thotë kryesore korzës t'u rrxu kerre, t'u rrxu, t'u mëshu vitrinave e sene u bo nifar' haosi në përgjithësi e sene. Atëherë sulmoj policia. Mandej e kishin policia shqiptare po ata ia morën kompetencat policisë shqiptare dhe ata ishin t'gatshëm. U shkrepën. Ni pjesë met' te Fakulteti Filozofik, ni pjesë përmrri rrugë do të thotë përmrri Fakultetin Filozofik. Ni pjesë u shkapërderdh knej kah rruga e Fushë Kosovës, ni pjesë nëpër qytet. Kadal kadal kah ni, kah dy, kah tre t'u u bashku.

Unë ma herët pata shku te Hyrija. Thashë, "Oj Hyri, çka po thu?" Tha, "Kqyre çka, shko drejt në shpi", tha, "se demonstratat po bohen", tha, "O' e di bre asine". Çfarë t'shkuni. Prej Hyrijes e te Fakulteti Filologjik. Po rri, po kqyri, po bërtasin rrnoftë ky, rrnoftë ai. Do njerëz i njofsha do të thotë si shpihuna e sene. Ata bërtitshin parulla që nuk ish dashtë m'u folë. Veç i kqyrsha. Ndërkohë vjen vëllau jem, qiky Normalisti. "Çka u bo?" Thashë, "Jom metë qitu. Vëllaun e vogël e kom çu te halla", përmrri qitu te Mensa e Studentëve, thashë, "E po i kqyri qitu çka po bojnë, tek po bojnë".

Ai u ofru me mu tha, "Krejt jena nëpër qytet po s'e kena lanë vendin m'u taku e m'u kthy në shpi po cili të shkon ma herët shkon direkt në shpi". Kishim kusheri prej Ferizajit që kishin ardhë as s'kishin dalë në Ferizaj se në Ferizaj paradite. Atje i vogël Ferizaji, njifeshin e mos m'i njoftë janë ardhë në Prishtinë. Plot tani janë bartë, do prej atjehit a dinë. U bo edhe popull edhe nxanës edhe studentë, po studentë

ma pak. Vajza ka pasë ma pak. Normalista ka pasë diçka ma shumë. T'u nejtë, t'u dëgju ndërkohë ky Krasniqi, emri tash p'e harroj, Partinë Demokristiane që e ka pasë...

**Anita Susuri:** Mark?

**Mejreme Shema:** Mark Krasniqi po. Dul poshtë tha, "Hajdeni ni grup i studentëve edhe tregoni kërkesat e juve. Po i shënojmë shpërndanu nesër në mëngjes ju tregojmë çka po ndodhë, tek po ndodhë". Kush me dalë, kush me shku. Kërkush s'ishte që ka organizo, domethonë, kërkush s'ishte. Unë isha në qosh, "Mejreme a po vjen?" Thashë, "Jo s'muj, unë s'jom organizatore, unë kom dalë si qytetar. Çka di unë çfarë kërkesa kanë pasë?" Aty u përzin kërkesat, u përzin tonat. Niherë prej naltit prej dekanatit t'u thirrë, t'u... kërkush s'lëvizke, s'shkojke.

"Ja shkepuni e leni kërkesat se nata osht', ju bijnë", kërkush hiç. Fat në fatkeqësi vijnë do shokë të vllaut Normalist me flamur t'u ardhë prej qytetit. Thotë, "Sahit, e kanë burgosë Femi Pushkollin, e kanë burgosë këtë profesor", këtë, këtë, këtë thotë edhe, "Çka u bo? Qysh?" Thotë, "Qishtu thanë i kanë burgosë, duhet me shku m'i çliru", "Hajde po shkojmë". Tash na që ishim si në fund tash na dolëm të partë. Ku po shkojmë? Po shkojmë m'i shliru. E lam fakultetin e jemi nisë.

Kemi mrri deri te Grandi aty, domethonë, pllatoja ma thellë. Qitu thom, "Stop". Ishim në rend të parë unë, vëllau, do tjerë. E ma vonë plot thojshin jena kanë edhe ata. S'di, ni vëlla temin e kom njoftë, tjertë s'i kom njoftë. Jemi nalë qaty se ushtria, policia ishin bo kordon. Me shku shkojshe në zjerm. "Ndaluni", rrishim, ata rrishim, na rrishim. Fillun me gjujt prej ndërtesave të larta ka qenë. Domethonë kemi mrri deri ka qenë ni shitore për zjarrfikësa për këto, tash nuk osht' po qaty ka qenë, deri aty. Ma s'ke pasë, "Mos gaboni se vallahi gjujnë". Ku t'len me shku ty në burg.

Jemi nalë qaty. Kanë gjujtë prej s'naltit me kësi të luleve saksia e me gjithçka po kanë gjujtë edhe me armë. Siç jom kanë me flamur t'u folë diçka me vllaun, veç e kom ni nifar' të nxehi qitu pari {tregon me duar tek pjesa e kokës mrapa} thashë more diçka po m'vjen nxehëtë a din. Për mos m'u rrxu shtyjmë atë drunin e flamurit e kom pshtet për toke, kocka ka pasë e jom majtë për to mos m'u rrxu. Ka nga tani m'ka kap vëllau, gjaku m'ka dalë teposhtë. Dikush a qit' duhan a diçka qishtu, e pshtjellë me ni këmishë e diçka edhe qashtu.

Jemi kthy, jemi kthy. Dikush, "A po don me t'çu në spital?" Unë në spital punojsha, thojsha, "Jo në mramje në këtë natë nuk shkoj se s'di çka të bojnë". E me shku apet jom kthy te fakulteti, a din. *Bam, bum e bam, bum* {onomotope}. Dikush thotë kështu, dikush ashtu, ky rrnoftë, ky rrnoftë. Ishin hala do në burg e sene me emra e me mbiemra. Dikur nuk e di valla, apet ky, Krasniqi, Marku ka dalë, "O' njerëz shkepuni, nuk ka shtet ma në dorën e policisë tonë. O' shkepuni o' gjysa keni me vazhdu atje në burg". Se plot kanë marrë po tani dikush janë largu, dikush i ka hjekë hala pa i marrë emrat e ka pasë të njofshëm, "Dil shko. Mos prit me ta marrë emrin se të dënon ni muj ditë".

E kemi taku Femi Pushkollin, Fetah Bylykbashin edhe njo i tretë nuk e di, kom harru kush. Po ia bon vëllau, "Qysh bre profesor, a s'të kanë marrë ty në burg a?" Tha, "Jo valla, nuk më kanë marrë. Pse kush tha?" Tha, "Na kem t'u dekë për ty e për do tjerë që thanë janë në burg". Kemi shku te poshtë, kom shku në shpi. Ma kanë pastru pak këta, jom ra unë tani ata kanë ardhë kah njo kah njo. Edhe kusherit e Ferizajit e sene u bo shpija plot, s'kanë flejt deri në mëngjes t'u folë, t'u bisedu.

Unë në mëngjes jom çu e pitë pak po apet nom. E qita ni kapelë edhe drejt te puna shkova deri në spital, kisha me punu masdite. Kur shkoj p'e kqyri situatën qysh osht'. Çka me pa? Populli jonë qysh osht' a din, e kanë mytë njanin, filanin e kështu. Krejt për mu folshin, a unë isha qaty. Haj kuku për mu (qeshë). Tash kjo, se ata edhe kanë fotografu. Kjo sot jo nesër masnesër kanë me m'gjetë, kanë me m'burgosë e kështu pse mos m'u lajmëru. Po bisedoj me ni kolege aty thashë qishtu qishtu, "Unë jom plagu. Kom dalë m'ka"...

**Anita Susuri:** Me armë ju kanë plagosë?

**Mejreme Shema:** Po, po. Qitu {mrapa kokës}. Shkova u lajmërova poshtë atje, e çela historinë. Kanë qenë edhe disa të plagosun nxanës të Normales e sene kati ne tretë. Na rujke policia, po jo kumeditë sa a din. Unë dilsha shkojsha se masi punojsha aty, ma e lirë isha. Bile ni, ka qenë ni malazez tha, "Shko fotografoje", tha, "kokën se s'dihet". Shkova e fotografova kokën. Fakt që ajo veç është çà a din se me konë me saksi e sene bohet e zezë, tumhavet a din, vendi. Po ajo plumbi qysh ka kalu rrshitzëm veç e ka çà lëkurën edhe ka depërtu. Fati.

U lajmërova, erdh policia meniherë. Nja katër ditë kemi nejt. Domethonë me dy dhjetor jom lëshu '68-ten edhe jom nisë me shku në shpi. Bile ka qenë ajo nji që i prejke floktë ktyne t'smutve i rrujke. Thashë, "A po m'i pren pak qito flokë? Varra mos t'më kapet" {mrapa kokës} tha, "Po". Drejt po shkoj unë arave nëpër kollomoq me dalë rrugës trup. Kur kanë ardhë ata, "Valla po thojnë shkoj në shpi se e kanë lëshu". Ata ma t'shpejt se unë me kerr.

Si kom dalë prej kollomoqit në rrugë kryesore tap {onomotope}, "Ha ku po shkon?" "Kesh t'u shku n'shpi", "A e din që s'munësh me shku", "Po s'e kom ditë, s'u ardhë kërkush me m'thanë mos shko në shpi. Veç e mora letërlëshimin edhe po shkoj në shpi", thashë, "kurgjo ishit ardhë m'kishit marrë në shpi edhe kurgjo". "Jo", tha, "po t'marrim qitash drejt atje" (qeshë). Më dënun ni muj ditë me burgim, a din, për kundërvajtje qishtu. E majta. Mas dy jave, "Po ankohesh", thashë, "Jo s'po ankohna. E keni pa që komu përmirësu me ni muj po e maj ni muj", qashtu.

**Anita Susuri:** Në Prishtinë keni qenë?

**Mejreme Shema:** Po në Prishtinë, në Prishtinë.

**Anita Susuri:** A ka qenë pak ma ndryshe...

**Mejreme Shema:** Po, shumë ma ndryshe. Kur kom shku do të thotë, të njejtit kanë qenë njerëz, ni Tumi, ni që i kom pasë do të thotë m'kanë marrë në pytje e sene. Po tash pak ma gjentil, ma asine. "Prit Mejreme derisa të vjen tjetri jo vet". Na tash i kemi përmirësu do gjana do sene. Thashë, "Valla po më vjen mirë shumë që i pasni përmirësu". Erdhen tani u bonë nga dy vet a tre e sene. "Çka ka ndodhë?" Thashë, qishtu qishtu, "Kom dalë me pa çka ka tek ka qëlloj me qenë e para m'shtyjtën masa t'shtyn t'qet përpara. E mrama isha dola e para. M'ka kap plumi, fati që kom shpëtu mirë edhe qe". Ni muj ditë e majta. Dola.

M'përjashtun. Niherë më suspendun. Bile sekretar ka qenë ni msus i imi në shkollë filllore "Azem Vllahu". "Çka po gutesh? Le rrogën ta japim hajt kadal kadal", thashë, "Jo bre se po du me hjekë hiq qafe a po m'kthejnë a s'po më kthejnë a din". I ndjeri Xheladin Deda ka qenë në komisionin a din me i marrë në pytje e sene e lëshon thotë, "Hajde bre çfarë pytje me marrë unë s'du me qenë komision". Tani komision ishte ky, Krasniqi, Selim Krasniqi, doktor i ginekologjisë.

"Po çka ke bo?" "O' kom dalë rastësisht", s'kishe, e lëshun vendimin Telat Pallaska ka qenë ato nivelet, çka e di, të kryesisë ato kush i bon edhe u përjashtova. Vazhdova tani studimet. Anglishten e mata regjistru veçsi, a din, thojsha me regjistru gjuhë letërsi unë kisha shumë qef thojsha po thojnë ha qe kjo nationalistja po shkon tamon kështu. Thashë hajt anglishtën s'më lodhin. Po kurrë s'ma dhanë pashaportin, as në Turqi me shku. Punëtor isha për tetë mars që shkojshin gratë e sene mozallah, kurrë hiç.

Deri '84-ten domethonë tre katër fmi i kom pasë, krejt fmitë valla. Krejt fmitë i kom lindë, i kom rritë unë pa pashaportë. Me burrin me shku në pushim në Greqi në krejt. Tek qatëherë e kom marrë pashaportën në '84-ten pashaportën teme.

**Anita Susuri:** E mas kësaj periudhës të '68-tes demonstratat, a ka vazhdu prapë aktiviteti juaj apo është shukatur për ni kohë?

**Mejreme Shema:** Të thom t'drejtën kjo lëvizja jonë është shukatë në shtator, unë nuk e di që ka vazhdu. Si thotë dikush e ka vazhdu, e ka vazhdu ndoshta me njerëz tjerë. Po me qata njerëz të ktuhit, te na, unë nuk e besoj që është vazhdu. Ademi ka qenë n'burg, shumica n'burg t'dënun e sene. Sabri Novosella osh' liru pastaj e do tjerë. Ai e ka marrë përsipër që e ka formu, e ka vazhdu po nuk e di. Me njerëz që kemi qenë jo. Se unë kom nejt edhe me Sabri Novosellën, ka punu si rrobaqepës e krejt. Po asniherë s'më ka thanë valla po vazhdoj unë a diçka, a don me ardhë a.

Se m'lutshin do njerëz, do tjerë, po unë e disha që kush janë e tek janë edhe s'ju besojsha. Thojsha, "S'po du m'u marrë ma me këtë punë. Po du me vazhdu me punën teme, kontriboj në mënyra tjera. Me kto nuk po ju besoj njerëzve", edhe qashtu ishte. Më njeke ni student, "Kena armë, kena kta, hajde a po

vjen në organizatën tonë”, “O’ djalë, unë nuk po du me ardhë kërkund, unë po du me studiu me kontribu me punën teme”.

Derisa m'u dashtë ni shokut m'i thonë, “Amon a po ma hjekë qit' njeri”. Saherë që dilsha e takojsha. Thashë, “Le t'i jep armët ty” (qeshë). Ka qenë Halil Alidemaj. Thashë, “Pashë zotin del i thu që le çikën rahat edhe mos e nguc”, ma tani nime s'më nguci. Ka qenë njani, s'du me ia përmend emrin. Masi jom largu prej punës atje në Lipjan, për çdo ditë që më takonte. “Çka po don bre?” Prej natyrës nuk jom që gjuj fjalë e ofendoj, veç e dëgjoj çka po thotë e po thotë, a din. Tashti s'mujshe me nejt mbyllun.

Ishë vjeshta edhe pak si riga shiu, sa kisha pushu thashë hajt të dal në qytet e shoh dikond, shoqe a dikond. Po te teatri n'ta. U ndala. “Çka po bon?” Qishtu t'u ecë a din teposhtë, p'e shoh po përkulet, “Mirëmrama”. Kur p'e kqyri Ibra Haska. Thashë, “Kond u përkule? Kond p'e nderon?” Tha, “Po m'ka thanë që me pasë kujdes se shumë kokëfort je”, thashë, “A ti don me ma hjekë mu kokëfortësinë a? E me m'çu te Ibra Haska me folë me ta a?” Thashë, “E kom kry me Ibra Haskën s'kom punë me to”. Aty, aty i thom, “Kurrë ma mos më ndal”. Edhe nime kurrë s'i kom folë, kurrë s'jom ndalë me to.

‘95-ten në Berishë përshkak të Rifat Berishës e ni takim për herë të parë merrshin pjesë shumë njerëz e krejt asine. Policia boll u mundu m'i ndalë. Unë shkova me Hyrije Hanën na çonte dikush me kerr. Në Arllat na ndalën, “S'muni”. Unë isha Shema se isha e martune, mbiemrin s'e kisha Berisha. Këta çka ishin Berishë e sene ata i lëshojshin. Thashë Hyrisë, “S'kom çka me t'ba. Ti me kerr kthehu në shpi, unë e di rrugën në Arllat përmas dal në Berishë”, “Qysh?” “Hajt. Ti s'munësh me ecë se të kisha marrë a din”.

Veç shkoj te dajtë e babës e gjeta dikond se ata krejt ata, po do gra. “A osht’ qikjo rruga për Berishë?” “Po”, tha, “të qet’ direkt te shpijat”. *Tap - rrap* {onomotope} mrrina. Plot popull e sene. Dikush recitonte, dikush sene. Ai ish aty u munojke... tash po i thotë vëllaut, “A ka naj poezi me recitu me lexu?” Thashë, “O’ hiqma allahile mos më lodh, çfarë recitimi çfarë leximi këtu”. Dikur vëllau tha, “Le, mos asi”, tha, “të ka thanë që mos e nguc edhe s'ki ma”. Edhe nime kurrë s'i kom folë ma hiç. Edhe tash mas luftës dy-tri herë m'ka ra rasti për urime kështu, tak. Tha, “Kuku qysh s'po ta lëshojnë venin këta atje me ditë kush je ti”, thashë, “Jo bre s'ka nevojë” (qeshë). Se tash dojke me kërkua a fale a çka po di unë. E qishtu ka qenë.

**Anita Susuri:** E pas diplomimit a keni gjetë punë apo si ka vazhdu?

**Mejreme Shema:** Jo. Kur kom hi në punë kom hi në ‘79-ten. Domethonë në ‘78-ten e kom lind vajzën e tretë edhe hala në gjii e kom pasë kom fillu në shkollë ekonomike. Me kontratë ka qenë ni vit. Se atëherë e mirrshe me kontratë e pastaj tjertë asine. Drejtori ka qenë serb, ka qenë afër penzionimit. Rastësisht takohem me burrin t'u shku në Beograd edhe ai i kishte këto bërthamat e përbashkta. Nuk e di për çka.

Ai i thotë, “E kam gruan qishtu pa punë”, “Çka ka kry?” “Gjuhë dhe letërsi”, thotë, “Te unë është ni vend le t'i bjen dokumentat”. Tybe s'i kom çu, i ka çu burri. Ju ka thanë atyne, ka qenë ky Rexhep Osmani edhe njo i Pejës, zëvendës. Thotë, “Çka doni boni, veç qit' gru të qitij shokut me ma pranu”, “Ani”, thojnë, “ta pranojmë”. E dishin kush jom se ai Osmani, Rexhep Osmani me vëllaun ka qenë në normale. Student i burrit e krejt.

Po më thotë ai drejtori tha, “Bre diçka”, tha, thashë, “Kush bre të ka mush për mue”, a din, “Po ti”, “Kurgjo krejt rrena janë. Hiqmu tyne se këta kanë qef me pa vetën pak ma nalt me qisi rrena”, “A osht’ qashtu a?” “Hajt qashtu osht’ punë e madhe”, (qeshë). Kaloj, a din. Erdh fundi vitit, u dasht me përfundu. Kishte mundësi po u zgjodh drejtor Rexhep Osmani, nuk ma vazhdoj kontratën. U dasht me shku deri në Fushë Kosovë, ka qenë Gjimnazi Hivzi Sylejmani. I kom pasë aty do orë, jo të plota. Po drejtori më priti mirë, kolektivi ishte i vogël i mirë.

Ishte vështirë se s'kishte autobusa. Prej Bregut të Diellit u dashke me shku në kam me dalë atje te Dardania për me shku për Fushë Kosovë ni autobus. Haj more zot. E gjithmon u vonojsha. M'vijke keq. Ai i mante nxansat, nuk i lëshojke me bo zhurmë. “O’ drejtor, vallahi po më vjen keq po nuk po kom çka me bo”, “Hajt se s’ka problem, qe unë po i mbaj”. Ma vonë dul, i zëvëndesojsha një gjashtë orë në universitetin e punëtorëve, shkolla e natës. Ata kërkun ni arsimtar të gjuhës dhe letërsisë. Masi isha me gjashtë orë aty m’pranun.

Po kur m’pranun aty meniherë mas dy-tre mujve drejtori, “Ja me t’qit’ prej punës”, se me hjekë prej vetës, “qysh e kom pranu armikun”. E dishin kolegët e sene e krejt. Po hajde me t’çu te ushtart, nisi ishte bo puna qishtu atmosfera. Tash i ngarkun ushtrinë që me mbajtë shqip ligjerata e sene, m’i msu ata shqip. Erdhën njo i Zagrebit, njo i Maqedonisë, njo s’di prej kahit. Tetë i kishte kolega tjetër, ai ni vit përpëra. Tash mu më angazhun se u rrit numri, unë i kisha gjashtë.

Unë nuk dojsha me shku. Unë e disha që me ushtarë duhet me punu diçka e kisha nifar’... thojsha, “Nuk e kom që asi diçka po nuk di me dhanë mësim. Unë kom mësu me dhanë mësim shqiptarëve me folë për Çajupin, me folë për ata, me folë për këta e jo me mësu si kurs”, a din. Ai drejtori mu s’më bojke za, ju thojke atyne, “Valla ka me shku, ja ka me shku ja ka me dalë prej punës”, se dojke me hjekë prej vetit. Haj moj bela çka u bo kjo punë kështu, kurrë s’po rahatohna.

Niherë, niherë thotë, “Mos e ngucni, na vijnë e testojmë e kqyrmi”, unë nuk thojsha që s’po du për shkak të kësaj e ksaj. Po thojsha, “Nuk di me dhanë mësim, nuk po du me marrë ni punë që nuk e din”, a din. “Na e vërtetojmë”. A unë boll mirë e disha se edhe anglishten e kisha, kurse jo këto a din. Pysin ata në mramje në SUP. Qëllon ni Kllokoqi. Bisedon. Ai e ka njoftë Isakun, burrin tem. Edhe ju ka thanë, “A e njifni?” “Po burrin ia njoh, është profesor në fakultet”, thotë, “kështu i mirë e krejt. A grun vallahi nuk e njoh po besoj që n'rregull osht”, “Eh po mirë, ani”.

Kur shkoj unë, masdite punojshim. Burri jem punojuke deri vonë, deri tre-katër, unë mas katërve shkojsha në punë ai rrijke me fëmi. Vjen ni koleg, jepke para ushtarak, kusher i qatij Kllokoqit. Thotë, “Mejreme”, thom, “Çka?” Tha, “Dikush ka pytë për ty”, tha, “në SUP”, thashë, “Ku dreqin bre?” (qeshë) “çka u bo?” Tha, “Vallahi po”, tha, “ai kusherini jem tregoj” tha qishtu, qishtu, tha, “Nuk e di veç ka pytë”, qishtu. Mas dy-tre dite erdhën, njana ishte me fakultet të anglishtes që erdh po punonte në ushtri. Erdh ni komandant i ushtrisë. Me prit me shku. Hyna në mësim.

Në mramje t'u mendu në shpi thashë me më largu mu që s'di a, thashë, jo kurrë. Ma mirë le të më largojnë që s'jom domethonë për këtë punë jom armik e sene e jo me thanë e largum që s'dike me dhanë msim. Thashë, vallahi... te përgatis unë mirë. Ai kolegu ka qenë i Gjilanit. Shkum e majtëm ligjeratën, msimin. Na morën tash. “Pse s'po don me punu?” Thashë, “Jo që s'po du me punu po unë po kom frikë që nuk muj me dhanë kontributin se nuk kom punu unë kështu si kurs. Unë kom punu me nxanës shqiptarë që me ju shpjegu historinë e letërsisë e tjera”, thashë, “atyne s'muj me ju shpjegu. Tash nuk di çka me ju bo”.

E kisha ni libër të Gani Lubotenit për të hujt a din po edhe ajo nuk ishte kumeditë çka. “Jo mirë e ke majtë orën jo mirë. Nxanësit janë shumë të knaqur me ty”, thashë, “Ani ishalla janë mirë, shyqyr pra”. U kry. Kthehna unë te drejtori jem. “Ha, çka u bo?” Thashë, “Drejtor, më pranun thanë shumë mirë po din me shpjegu, shumë mirë, edhe unë po vazhdoj me punu”, “Ani shumë mirë” (qeshë). A krejt ish përgatitë me më largu, a din, se nëse s'e largojnë këta thotë me hjekë prej pune. Po meta tani. Jam penzionu në qat' shkollë.

**Anita Susuri:** Deri në penzion keni punu?

**Mejreme Shema:** Deri në penzion kom punu, tani u bo si shkollë e rregullt. Tani vitet e '90-ta ishte gjitha shkollat kalun në mësimin paralele do të thotë nëpër shtëpitë shkolla. Kushtet ishin shumë të vështira. Tepër edhe populli edhe prindërit edhe nxanësit edhe arsimtarët kanë kontribu shumë se osht' vështirë me çu fëmin ti në gojë të armikut. Për çdo ditë i ke pasë t'u i taku policët, atë tjetrin e dikond e kanë rreh. Po e mbijetum edhe atë vështirësi e sene.

Vazhdum në ato kushte. Unë bile e kom bo ni film dokumentar për ato vite që kem punu e sene. Në Shqipëri pastaj shkova në '96-ten me bo montazhën e tjeter s'kishim ku. Osht' ni film që tregon të vërtetën çfarë kushte, çfarë rrethana kena punu. Kom qenë edhe te babgjyshi i saj, këta kanë majt shkollën e muzikës aty. Po ditën e kanë përgatitë për shkollë, natën këta kanë shku kanë fjet aty se s'kanë pasë ku me fjet. Domethonë nuk e ka lëshu shtëpinë ajo elitë që ka pasë mundësi ma të madhja po e kanë lëshu njerëzit e thjeshtë. Njerëzit me dhanë ni kontribut që qe në qito kushte, në qito kushte po bile po du me nda të keqën me të tjerët.

Kështu kemi vazhdu. Domethonë kanë qenë lidhja e arsimtarëve “Naim Frashëri”, sindikatat e pavarura, lëvizja demokratike. Tanat kanë marrë ni vendim për me fillu në qito kushte, në qito

rrethana, mos m'u grumbullu. Se nuk e dishe ti kur... thojshin, "Hajt se mas ni muj a dyve kemi me u kthy", "O' nuk kthehesht ti kurrë ose duhesh m'u kthy duhesh me pranu çka të thojnë ata". Edhe qashtu ishte. Për shembull në universitet të puntorëve filani, filani, filani, "Nëse nuk punoni me programet e Serbisë jeni të përjashtun" edhe u përjashtun. Qashtu edhe në shkolla tjera, me vendime.

Krejt i kom edhe i kom bo gati m'i dhanë për digitalizim. Janë dokumente të rralla. Për shembull dikond largu prej punës, qysh i kanë shkru ose me programe tona ose largohuni prej punës. Njerëzit në ato halle, në ato kushte formun sindikata. Unë isha kryetare e këshillit ekzekutiv të shkollave të mesme, kryetari ishte i Prizrenit Ilmi Gashi e disa të tjerë. U munojshim. Shtir boll ka qenë. Po aq e ndij vetën nifar' nifar' lehtësimi kur mendoj që kom kontribu në atë periudhë i kom njoftë arsimtarët, i kom njoftë shkollat, nuk kom hezitu e sene.

Domethonë nuk kom qenë vetëm ni arsimtare e gjuhës po kom shku në secilën shkollë e kom vizitu. Me secilin arsimtar me bisedu m'i ndihmu diçka në ato kushte sa kemi pasë mundësi, se 'skemi pasë shumë. Tash kur t'i mbledhsh ti thu kanë ardhë 20 mijë franga. Po 20 mijë franga ni shkollës nuk i dilshin me ia dhanë kah 100 euro. po ajo ndarja ishte e shkollave e shoqatave, na e kishim me ia dhanë në bazë të arsimtarëve që kanë secila shkollë 100, 300 sa qysh vishin, tek vishin.

Me ndihmu naj njo që është ma në vështirësi, që osht' smutë, që ka shumë fëmi ose banon me qera e sene. Krejt qito i kemi ndihmu ma mirë se sot sindikatat që po punojnë, beso. Kemi negociu me drejtore sene se ju ju ka bo ni e padrejtë. Sot kush? Sot kurgjo, veç mendimi te parja, te interesit te sene, kurgjo.

## Pjesa e Katërt

**Anita Susuri:** Po du me folë edhe për disa ngjarje që i kanë parapri viteve të '99-ta edhe krejt pasojave që janë konë. Kanë qenë edhe demostratat e '81-tes, ju keni qenë mësimdhënëse atëherë...

**Mejreme Shema:** Po. Demostratat e '81-tes janë, për herë të parë janë me ni prill. Domethonë jom pranu në universitetin e punëtorëve. Janë demostratat kanë marrë pjesë nxanës, arsimtar, popull, studenta të gjithë. Kjo është ni pjesë e diskutueshme që askush nuk e merr organizimin, kush e ka bo organizimin, kush asi. Domethonë osht' ende e pa sqarune. Dalin disa dhe në biseda mirren, nxirren, burgosen secili po nuk e merr askush që valla unë jom organizator. Osht' fillu në Mensën e Studentëve. Nifar' demostrimi që jo ushqimi, jo ky, asine. Pastaj, tani kanë dalë nëpër qytet nëpër asine. Në fund, në mramje janë blloku studentët, nxanës e tjerë te kjo "1 Maji" këtu...

**Anita Susuri:** "1 Tetori" tash.

**Mejreme Shema:** Po. "1 Tetori" m'fal, "1 Tetori".

**Anita Susuri:** Atëherë ka qenë “1 Maji”.

**Mejreme Shema:** E nashta ka qenë veç “1 Tetori” po m’kujtohet. Shkonin këta profesorat e fakultetit deri te dera m’i pa studentat qysh po rrjinë, ata rrishin qaty. Unë kom qenë t’u ardhë përpjetë, i kom pa klasën teme komplet të shkollës ekonomike. Ata s’dishin me u kthy me shku nëshpi të vetën. Ju thom, “Ejani te une në këtë anë”. I kom çu deri te shpija i kanë la sytë, i kanë la durtë e sene prej ktyne qepëve, me qepë e sene prej lotsjellësit edhe, “Pushoni”. I kom qit’ deri te Rruga e Dubrovnikut te Fakulteti Ekonomik, “Qitash e dilni në rrugë”, “Qitash profesoreshë e dijna, e presim autobusin shkojmë për Podujevë”, “Mos u boni ma shumë se tre vet, shkoni ren po kah tre vet”. Kanë shku.

Çka kom bo, jom ardhë në shpi, kemi pasë do djem kanë qenë ma të ri, do të kojhive. I kom thanë, “Çu, kqyre buka ku po shkon kerri me bukë”, shkojshin çojshin këto që kanë qenë ku shitej buka. “Shko ktheje e çoja studentave këtu që janë mshelë në ndertesë”. Janë shku i kanë çu dy-tri kamiona janë shku i kanë çu bukë, çka ka pasë qaty krejt. “Po ku m’i lanë këto?” “Lej te dera ata vijnë i marrin mos ki gjajle”. Në akshom ju kom bo çaj. Burri i ndëgjojke lajmet, unë fëmitë, vajzën Besën, Artanin, ni vajzë këtu ka qenë Vlora edhe do djem tjerë në podrum. Zi çaj qiti sheqer e qiti në plastika të koka kollës e kah dy secili. Ishin të vogjël fëmija. “Shkoni te dera jepja dikujt ata ia japin”.

Çaji i nxehти ta hjekë të eqten, e ujtë e ftoftë nuk ta hjekë veç të fryn. Disa herë qashtu. Ai burri jem, “Çka je t’u bo në podrum?” “Kurgjo bre jom t’u rregullu diçka”. Fëmija shkojshin i çojshin vishin i merrshin tjerat e krejt. Thashë interesant, kush nuk i thotë këto sene. Ma tepër i bojnë do gjana që s’kanë qenë hiç, po nuk flasin për këto sene. Ai çaj dikush e ka pi dreqi e marrtë. U dashtë me pytë kush e boni a çka e boni, kush e pruni a. E kështu. Po me u angazhu nuk jom angazhu se diçka nuk kom besu tani ma, më hupi ai besimi. Nuk i besojsha ktyne organizatave se krejt ishin të lidhne me jashtë e këto. Diçka nuk kom asi.

Po nuk kom qenë indiferente do të thotë. Jom mundu në atë mënyrën tem me ju ndihmu njerëzve, jo në shkollë, jo ata, jo këta, nxënësit me ju dhanë, si me thanë, edhe ni rast me kalu. Niherë m’ka ndodhë në shkollë ekonomike ni nxanës që m’ka kundërshtu, tha, “Valla veç je femër se të kisha kallxu”, “O”, thashë, “bre. Kuna i kallxon ti? Çu me mu te drejtori”, edhe e kom çu. Thom, “Kape bon çka të dash”. Ai tash njeri nuk e din, ka pasë naj hall naj diçka edhe osht’ shpreh ashtu. Jo për shkak temin po edhe ma vonë kishte bo diçka. Osht’ përjashtu. Ka ardhë në provime në universitetin e punëtorëve. Kur e kom pa, jom nalë e p’ë kqyri. Tha, “Profesoreshë”, tha, “ti e kishe pasë të drejtë po i kom pasë”, tha, “do probleme, do sene”, thashë, “Mu m’vjen mirë që e ke kuptu”, edhe ju ndihmojsha.

Ata e kishin për ni punë, për ni diçka. Se me shkollë fillore çka bojshe. Kemi ndihmu. Kemi ndihmu atyne të Maqedonisë, të Malit të Zi, të Ulqinit shqiptarëve e sene me ardhë se atje s’kishin mundësi m’u shkollu e sene. Po edhe ata na kanë kthy pastaj gjatë viteve të ‘90-ta. Secila shkollë shqipe në Maqedoni ka mbledhë mjete, na ka pru për ndihma e sene. Po ashtu edhe ata të Malit të Zi edhe të

Bujanocit, të Medvegjës. Diqysh ka qenë ni, thom, niherë se kom marrë thojsha çka osht' sindikata. Baba jem thojke, "Oj bijë, sindikata osht' dorë e djathtë e pushtetit", thojsha, "Jo bre babë se tash na e kem në dorë", "Hajt se të kallxoj", thojke, "ki me ditë". Kur ta kqyrsh gati qashtu. Se njerëzit, lalmia, për pozitë e sene, ndasi e do gjana kështu po u tejkalu edhe ajo.

Na arsimi i mesëm nuk e vazhdum pas luftës, u kthym në shkolla në puna me dhanë kontributin tonë. Sot e asaj dite kontaktoj me ata shoktë. Po thom kanë qenë tepër të mirë, jo pse unë veç ni femër po çfarë lufte u dufke me bo për me pru ni vendim. Se ata ishin krejt djem, a din, burra asine. Unë veç femër. Jo me thanë hajt t'ia lojmë kjo asi. Jo, jo. Debat u bojke. A qishtu apo qishtu a pse qishtu. Ose pse me filanin qishtu po, thojsha... "Mos e ka ai naj punë private", thojsha, "Çka ka punë me mu s'ka as me mu as me burrin tem s'ka. Po ata i kanë hesapet e veta e sene". Derisa u detyru nënkyetari Isa Bicaj e përzuni atë tha, "Ma kurrë mos hajdeni te na, na i kena detyrat tona edhe i kryjmë".

E lam tani. Tham hajt tash osht' ni formë e re e jetës, duhet m'u angazhu në zhvillim e krejt këto. U angazhum. Me të thanë të drejtën vëllaun e kom pasë shumë aktiv edhe duhet me marrë se ai në shkollë Normale demostratat ai i ka udhëheq. Pasi jom largu prej punës që u dënova ni muj ditë në burg për '68-tat, shkova u regjistrova në shkollë të naltë gjuhë dhe letërsi. Gjeta koleg, gjeta shoqe, mirë, kemi shku mirë. Kemi pasë ni... edhe arsimtartë kanë qenë të mirë e sene të gjithë. Kështu që ishte "28 Nëntori" na i tham arsimtarëve, "Valla s'kena me ardhë në msim", ni grup i joni. Tham, "S'kena me ardhë në mësim. E festojmë qishtu dikush në familje dikush", asi.

Dolëm me pi ni kafe shkollën e lartë poshtë në podrum edhe pastaj secili u largu me shku kah shpija. Une prej atyhit erdha drejt në fakultet. Kisha diçka vërtetim a nuk e di çka me marrë. Rastësish takohna me Isakun, e njifsha ma herët po s'isha nalë kurrë me taku as me bisedu me ta as kurgjo hiç. Thashë, "A din çka, kom nevojë për ni material shqip", kisha me bo për kohën antike diçka, "a munësh me m'i gjetë?" "Po more qysh jo". Qaty. Ni ditë me ni takim e jo ni diçka e sene. Unë domethonë as që m'ka shku menja diçka, as s'isha e interesune as kurgjo. Ia ktheva atë skriptën e krejt.

Ni shok i jemi po m'pytë, "Çka i ki puntë bre?" "Mirë bre mirë në rregull", "Jo", tha, "ti s'po kallxon", "Çka me kallxu more s'kom kurgjo me kallxu", "Jo", tha, qishtu qishtu, "me profesorin Isak", "Haj kuku për mu, po a une me konë me to a tjertë?" Thashë, "Unë po të kallxoq që s'kom kurgjo as s'më ka shku menja as hiç, hiç, hiç", "Jo", tha, "fakulteti t'u folë". A din njerëzit qysh janë? Thashë, "Jo vallahi as s'më ka shku menja veç hajt p'e kqyri. Po a thanë çfarë njeri osht'", "Jo", tha, "p'e lavdojnë shumë", "Hajt pra, mirë masi p'e lavdojkan edhe u boftë diçka mirë osht'" (qeshë). E kështu ia kemi fillu.

Tani në atë kohë, në atë periudhë kom shku në SUP më kanë marrë. Kur u zgjedhë Feriz Krasniqi rektor, unë në mëngjes jom shku në burg. Na ishim në shkollë të lartë edhe shkum delegat une edhe ky Banush, qaty në fillim të Shkollës Gjergj Fishta e ka pasë shpijen, Gjemshiti. E pam që kryetari i rinisë e sene po zgjidhet kush po don, komiteti e zgjodhi, tha, "Une". Ishte Drita Dobroshi tha, "Unë e zgjedhi, s'keni çka". Dikur po i thom ktina, "Ulu se s'osht' puna që mun lufton po rri allahile". Ky tha, "U kry kjo

punë". Masdite ishte ni koktel. Unë shkova në koktel po bisedoj, po rri. Kisha shokë të gjimnazit e do tjerë, i njifsha do i kisha si familjar e sene rrija me ta. Ndërkohë ka ardhën disa profesora edhe ky Rozhaja. Tash e ka ni dikush me këndu a nuk e di. Nuk e di, unë nejta pak edhe kom shku.

Isaku ka ardhë ma vonë, masi kom shku unë. Se jo punë e sene hajt ka thanë po shkoj pak. Unë jom shku në shpi. T'nesrit në mëngjes po vjen kerri policisë, "E kena lanë te tregu qatje mos me ardhë te shpija me t'bo problem", thashë, "Jo njejtë si atje si këtu", "Na po shkojmë nëpër treg po i bijmë", ata dy hetues përpara, shoferi ma mrapa. "Kallxom bre", thashë, "për çka osht' se tyben e di për çka", tha, "Çka keni pasë", tha, "pram. A keni pasë diçka aheng ju studentat e sene?" Thashë, "A për qata a?" Thashë, "Gjo s'ka pasë aty", tha, "Qashtu diçka, nuk e di veç për qata", "Mirë", thashë. A ke pa njeri kur e din diçka tani orientohesh.

Shkova thashë, "Kuku bre s'më lëshut kurrë, s'më lat' kurrë rahat", "Jo", tha po qishtu qishtu, "po na vyn me kallxu drejt a kishe mujt", "Ja", thashë, "çka di drejt ka me kallxu" (qeshë). Tha, "A ke marrë pjesë?" Thashë, "Po, jom konë. S'më ka pëlqy qysh osht' bo votimi e sene", thashë, "po s'ki çka bon, s'ki qysh me ndiku". "Po në aheng, në koktel?" "Po", thashë, "kom qenë", krejt ata partiasha po ishin si studenta e rrisha me ta. Thashë me filanin, me filanin, me filanin, thashë, "me qita kom nejt pak edhe jom kthy jom ardhë në shpi", "Po a e ke pa, a ka ardhë Dervish Rozhaja?" Thashë, "Po tybe e njoh", thashë, "Dervish Rozhajën se unë s'kom pasë punë me Dervish Rozhajën". Student i anglishtës.

"Kjo", tha, "kanë këndu", tha, "dikush profesorat kangë patriotike", thashë, "Jo, sa jom konë unë jo". Dervish Rozhaja e këndon ata, "Cakrroma gotën", e ka pasë gjithmonë. Po me thanë që e ka knu këta bijke që ka këndu tjerat. Thashë, "Jo", thashë, "sa kom qenë unë aty nuk kom dëgju që ka këndu kush kangë, kërkush. S'ka pasë kangë", thashë, "aty ka qenë koktel. E merr ni gotë pin, merr diçka, bisedojshim". Ka qenë ai, ni student, s'e di valla dikund i Preshevës a diçka. Daut Depërtinca ka qenë ka pasë kry shkollën e farmacisë, punojke në farmaci, student i mjekësisë, e kisha edhe familjar. Qatyt bashkë rrishim e sene.

Thashë, "Unë po t'kallxoj me kond kom nejt, shko pyti edhe natën e mirë", "Natën e mirë", jom ardhë në shpi. Kurgjo tjetër sen. Shkova e kreva ata u ktheva po takohna me Isakun edhe po i kallxoj. Thashë, "Valla erdha prej..." Tash ishte puna m'u zgjedhë ky Krasniqi, Feriz Krasniqi, rektor, a din. Po... thashë, "Jo, Ferizin nuk e njoh", thashë, "E di që është vëllau i Selim Krasniqit", thashë, "po nuk e njoh se s'kom pasë rast me pasë. Selimin e njoh", thashë, "se kom pasë rast me punu në spital", a din. Jo, po... "Jo", thashë, "nuk di as s'di çka me t'thanë".

Po i tregoj Isakut, ai e kish marrë vesh ma herët po u bojke që s'pe din, a din. Kurgjo. Nejse, shkoj u kry ajo punë. U zgjodh tani Feriz Krasniqi rektor. T'u dalë prej SUP-it n'qendër e takoj Selimin. I thom, "O doktor Selimi, prej SUP-it erdha", thashë, "për Selimin m'kanë vetë". (Qeshë). "A e njef?" "Ju thashë s'e njof se s'di". E keshqim. Po mirë. Tani u bo nifar' lirie, nifar' asi. Njerëzit pak u mundojshin me ndryshu jetën, me ndryshu konceptin e asine po ai i keq i keq jet' gjithmonë, a din. Mundohet me ndrru po kot.

Qysh thojnë, uku e ndrron gzofin po vesin s'e ndrron, s'e harron, a din. U dashke gjithmonë do të thotë m'u rujtë, me pasë kujdes e sene, po...

**Anita Susuri:** E kur e ka kuptu bashkëshorti juj që ju keni qenë e angazhune e kështu në aktivitete?

**Mejreme Shema:** Po me të thanë të drejtën si studenta, si krejt asij sigurisht edhe e ka marrë vesh. Po masi jena martu, domethanën, edhe tash frik, vjet kemi qenë në Grac te djali se djali jeton në Grac. T'u u kthy e përcollëm vajzën, ajo njana jeton në Angli, në Londër. Po tregon t'u shku rrugës, "E more ti Artan", thotë, qishtu qishtu, "ka qenë puna. Ose u dashtë me lanë punën ose u dashtë me u nda me grujen". P'e kqyri. A unë e disha po nuk e bojsha të madhe.

Se e di kur u vranë këta vëllazrit e Rifat Berishës në '49-ten, ka qenë e martune çika e Tahir Berishës e madhja me ni, se shokë janë konë gjatë luftës e mas luftës e sene. Si u vra Rifati e sene ai e lëshoij grujen. Se e majti pozitën. E nuk bojsha... flisshin, s'po don me çu në punë, qe ai s'po don me çu në punë katunar e sene. "O nuk osht' bre", thojsha, po kaniherë njeri kishte problem naj konfikt e sene. Baba jem thojke, "Oj bijë, kqyre, nëse ka ma shumë të mira merrja qato të mirat e për të kqijat ai pak naj sen diçka t'keqe secili ka behane, s'mujnë me kanë krejt të mirë", "O baba jem", thojsha, "deri ta merr vesh ai plasa kaniherë" (qeshë).

Kur po tregon thotë qishtu, qishtu. U dashtë me shku me marrë ata në pytje me diferençu, "Pse e ke marrë vajzën e filanit, familje armike?" Ky i thotë, "Në asni mënyrë nuk vjen shprehje, familja jem është familja jem", edhe fundi fundit le të më përjashtojnë prej pune nuk osht' problem. Ata vet nuk kanë shku s'kanë pasë guxim me... se ka qenë shumë i qetë, nuk ka bo muhabet fort me njerëz e sene. Po, jo nuk osht' nalë jo po qishtu filani tha, kurrë s'ke mujtë me dëgju diçka keq. Unë kom qenë pak ma e hapur se i kom njoftë arsimtartë e krejt asine.

Ka qenë ai Bashota, profesor i Fakultetit Juridik. Ai ka qenë shok i djalit të Rifatit. Kur osht' përjashtu ai prej shkolle ky e ka kry shkollën e ky i ka çu letër. Hanez letrën e tij e kemi marrë. I thotë, "Urime që ke kry shkollën". E ata e kanë çu. Ka nejtë ai me profesorat që kanë qenë ma aktiv në Lidhjen Socialiste në parti e sene. Secili pak e ka pasë. S'ke mujtë ti me punu në fakultet pa qenë anëtar i partisë, ajo ka qenë e pamundur n'atë kohë. Po tash varet, dikush ka ditë me punu si duhet, s'u marrë me sene të kqija.

T'u bisedu thotë, "Hajt se unë bisedoj me Iskaun". Thotë, "Isak", qishtu, qishtu, "po thojnë ata me t'marrë n'pytje", "S'vjen në konsiderim hiç, as nuk du me dëgju për këtë punë hiç". Ata tani në komitet janë shku e kanë thanën... ka qenë Petar Jakshiq, ai ka qenë mësus i jem, serbisht m'ka dhanë në shkollë fillore. "Valla s'mujna me marrë se s'po vjen", "Lene", thotë, "se unë e shfrytëzoj rastin e marrë në pytje". Kumeditë qysh ka ardhë puna ka shku domethonë e ka thirrë e sene edhe ka bisedu.

Ka thanë, “E kom pasë nxanëse ata edhe shumë nxanëse e mirë ka qenë edhe familjen e ka të mirë e krejt po çka ka ndodhë me to, s’ë di. S’kom njohuri çka ka bo tek ka bo. As e kuna osht’ se s’ë kom pytë e kuna osht’. Po unë mendoj që familja nuk merret me to sene, nuk duhet m’u marrë për bazë ose ndaju prej grusë ose maje punën”. Ma tani u shukatë, nuk e kanë, s’ë kanë thirrë asniherë as kurgjo. Tek ‘79-tën kom fillu me punu.

**Anita Susuri:** Thatë që vitet e ‘60-ta keni fillu nëpër shtëpi shkolla...

**Mejreme Shema:** Po.

**Anita Susuri:** Ku thatë që kanë qenë kjo shkolla?

**Mejreme Shema:** Po mendon shtëpitë shkolla?

**Anita Susuri:** Po de.

**Mejreme Shema:** Po na kemi qenë si universitet i punëtorëve kemi pasë degën e kontabilitetit, juridikut edhe tregtisë. E kështu që u aftësojshim nxanësit. Ka qenë edhe shkolla fillore në kuadër të universitetit të punëtorëve. Ma tepër ka pasë rom sesa shqiptarë po naj kush që e ka hup vitin e sene shkonin. Mirëpo u bo shumë atraktive. Në këtë shkollë njerëzit punonin, merrnin rrogën ma të madhe e sene, vinin, e krynin. Kishin kry filloren, donin me kry shkollën e mesme asine. Disa ishin që ishin përjashtu për shkak të demonstratave e sene.

Ka qenë ni vajzë e thirrshin Shote Galica. I kish pasë flokë të bukura të gjata e sene. Krejt arsimtartë t'u shku t'u e kqyrë e sene, unë s’ë kom ditë kurgjo. Vjen ni drejtor tjetër, shumë i mirë ka qenë. Ai ka qenë edhe drejtor i burgut ma vonë. Tani prej drejtor t’burgut e prunë shok te na aty në universitet. Po shkoj unë me nënshkru diçka. Po thotë, qishtu qishtu profesoreshë, thashë, “Vallahi unë s’kom ditë”, tha, qishtu arsimtartë e sene, tha, “M’u dashtë me largu ata”, thashë, “Keni bo keq drejtor”, thashë, “pse me largu arsimtarëve u dashtë me ju thanë a po shkoni nëpër klasa t’juja mos boni zhurëm”, “Jo se tani m’bojnë problem të mdhojt”, e kish pas largu.

Ni tjetër ka qenë, dikund n’atë anë kah Dobreva ni vajzë e re e mirë. Edhe ajo e përjashtune. Vjen. Dy arsimtar punojshin edhe në tregti, e në ekonomi kështu në administratë edhe jepshin msim. Ni ditë ajo po e nguc diçka. Vjen vëllau vet thotë, “Valla profesoreshë”, “Hajt lema”, thashë, “se unë e rregulloj këtë punë”. E kryjtëm mësimin hypëm, kishte njani kerr prej kolegëve thashë, “Hajde të shkojmë në shpi”, e kishim rrugën nisoj.

Tha, “Valla”, tha, “qajo nxansa e jote”, tha, “s’osht’ normal e kështu”, “Mirë bre”, thashë, “a i ke pa dokumentat e sajna?” Tha, “Jo”, thashë, “Shko kqyri te drejtori. A po shkrun që ajo është përjashtu prej shkollës për shkak të demonstratave? Jo. Ajo osht’ përjashtu se ka bo”, qishtu, qishtu, “jo. Ani çka po

don”, thashë, “ti?” Thashë, “Çka po don? Unë nuk e mbroj, në qoftëse ka bo qashtu ani qe ku osht’ drejtori i marrim dokumentat i kqyrim. Fundi fundit janë format, mënyrat e përjashton. E jo në këtë mënyrë me thanë valla ti p’ë man filanen e s’pe përjashton. Nuk është puna jeme me përjashtu. Mu s’më ka bo kurgjo, as nuk kom dokument të saj që ajo osht’ përjashtu për shkak të demostratave e sene”. U shukat.

Ma vonë tani e kom marrë vesh, vajza e ni djalit të shokut t’babës tem, me ni t’pame shkojshim na arsimtartë me pa dikond. Filanja a je ti a? “Ti mesën teme ma ke shpëtu”. Çka me bo. Tani shkolla jonë u bo do të thotë në nivelin e shkollave tjera, do të thotë, e ndrron atë formën që ka pasë universitet i punëtorëve, u bo shkollë e tregtisë dhe hotelerisë. Mas luftës kemi punu nalt kah Gërmia që shkon ka qenë nifar’ si, çka me thanë, konvikt e gjithçka. Masanej gjatë luftës kanë banu serb, kroat e serb që kanë ikë aty. Qata na dhanë me mbajtë mësimin.

Si sindikaliste që isha u angazhova meniherë qysh me bo m’i pastru shkollat. M’i pastru shkollat, m’i rregullu e sene. shkoj unë në UNHCR, UNHCR është qitu përballë policisë, a din ajo ndërtesa kap. Po pys, s’disha ku. Thashë qishtu qishtu, tha, “U shumë mirë ke ardhë. Sot mas dite mbahet mbledhja në këtë ndërmarrjen pastrimi”, higjena teknika është thirrë, pastrimi, tha, “Atje mbledhen janë krejt me KFOR e me të gjithë me pastru qytetin”, thotë, “edhe ti për shkolla”. Shkova, m’pranun mirë. Krejt dokumentat i mora, krejt asine.

“Çka po don?” Thashë, “Unë po du, niherë në Prishtinë ka shkolla ma shumë e sene po masanej edhe në qytete tjera. Me bo pastrimin”, thashë, “se kemi hy qashtu shpejt e shpejt. Pa u ly, pa pastru, pa kurgjo hiç”, a din. Ma dhanë ni t’hujin të organizatës të shëndetësisë. Ajo nifar’ Sara e Anglisë. Na e bom planin qysh çka tek për secilën shkollë. Mjetet, ato kantat e bërllogut, nxanësit qysh me bo me vizatu për shembull naj sen prej luftës a diçka. Ni shkollë me pasë dram, teatër. Ni shkollë tjetër me shkru ese, ni shkollë tjetër me vizatu.

Sot i mbaj mend shkolla atje te Medresja, “1 Maji” më duket ka qenë te Medresja. Shkrunte nxanësi i shkollës fillore, “O bre nuk po muj me ndëgju mësusen kah shpjegon prej sharrës që sharrit dru”. E tjetri vizatonte burën t’u pëlsit me bërllog thotë, “Qyteti u mush si kjo bure, po pëlset prej bërllogut”. Me krejt qito punimet e tyre e kemi bo kalendarin vjetor ‘69-ten, domethonë për vitin, ‘69 jo po ‘99-ten për vitin 2000 kalendarin. Ata i kanë shkrepë tani në KFOR e në tona antë. Në këtë Grand nja 20 i kanë ble ata edhe krejt qato pare m’i marrë, m’i mbledhë do të thotë me ndihmu shkollat e këto.

U bo shumë mirë, ni aktivitet shumë i mirë. Vallahi as nuk kom pasë kohë me shku në shpi m’u ndrru po qysh kom shku nëpër shkolla krejt me qato qashtu kom dhanë intervistën për televizor. As nuk e kom kqyrë, se s’kom mujtë me pa. Shkova në shkollë teme shoktë, kolegët e mi veç me dalë m’u fotografu, askush kacinë s’ë marrke me bo me punu. Unë me nxanës. Nxanësit më dégjojshin shumë. “Hajde”, “Oj profesorëshë, krejt për ty kena m’i bo”. A me fshi xhamë, a me pastru, a me hjekë barin, me hjekë ata.

E bom ni koktel tani për drejtora për do sindikalist. S'ka pasë atëherë fort meniherë. Qitu te Rruga e "Dubrovnikut" ka qenë nifar' asi. E qaty për disa drejtora nifar' kokteli e bom e nejtëm, muhabet bisedë. Po më vjen shumë mirë që ke ni iniciativë e mirë e tani ua dhashë edhe kolegëve në vende tjera, po nuk u vazhdu ajo e sene. Po fati që e morën të hujt në dorë. Atje në Prizren gjermanët e bon pastërt, e rregullun e sene. U angazhun.

**Anita Susuri:** Po du m'u kthy në periudhën e luftës, a keni qenë këtu kur ka fillu bombardimi e këto?

**Mejreme Shema:** Po. Na në mars domethonë fillun ato e sene, e ndërpren msimin. Erdhëm në shtëpi, t'u menu na që mrena mujit, mrena javës kena m'u kthy në shkollë. Po e kisha nifar' bindje që është e pamundur a din. Kishim njerëz që i marrshim informatat, kishim, ishin lëvizjet e këto. Dikush, dikush edhe ju dha kush munët me shku deri në 50 vjet moshën e sene. S'mujnë krejt me shku me ndihmu. Na e pritshim ushtrinë po ushtria e rregullt nuk ka qenë. Ka qenë krejt vullnetar, kanë qenë fëmi që s'kanë ditë me përdorë pushkën.

Po është ai vullneti i mirë që kanë dalë, kanë shku, kanë dhanë kontributin e vet e krejt. Jemi marrë vesh, kemi bisedu. Bile na si sindikatë kemi mbledhë pare. S'kemi pasë, kah 150 marka kemi pasë rrogën që na jepke 3 përqind nga jashtë, arsimtarëve. Po qato e kemi nda edhe kemi ndihmu këto zonat e luftës. Në Skenderaj, në Gllogovc, në Komoran. Bile e pata pak nifar' konflikti se dojshin këta të LDK-së dojshin me çu ma shumë aty këtu. Thashë, "Jo nuk shkon ashtu", thashë, "shkon në bazë të arsimtarëve që janë në shkolla. Nuk shkon barabar. Në Komoran janë 20 arsimtar ndërsa në Gllogovc janë 100. Duhet m'i nda".

Dy herë e kemi çu, domethonë i kemi mbledhë i kanë çu do tjerë e sene m'i ndihmu. Se metën domethonë kur filloj kështu m'u paraqit jo ushtar e sene, nuk muishe me lëvizë m'i çu rrogat e sene atyne ndihmat po sado kudo u gjindshin diqysh. Ka qenë e vështirë për t'gjithë. Unë e kisha babën te mensa në banesë, ishte i vjetër në moshë pak i smutë. Vëllau me familje, plus kishim të Drenicës dajtë e babës që ata ishin vet në luftë i kishin gratë e fëmitë këtu te baba e sene.

Unë e kisha vëllaun me fëmi, ka qenë i ndam prej grujes. Banonte poshtë në qendër, domethonë, te Baholli i thojshin. Ka qenë nifar' firme Baholli me kerre. Shkoj në mëngjes i marr thom, "Qyre, hajdi se s'i dihet puna qysh tek, hajdi në shpi te une". Vëllau punonte në bankë, banka ka qenë në atë kohë në falimentim e sipër. Kanë mbetë ni grup edhe shqiptarë edhe serb që me falimentu. Ai ishte i detyrun me shku për çdo ditë në punë. Filloj. Me t'thanë të drejtën niherë në fillim boll vështirë. Se unë isha në lëvizje, degën e tretë.

Kemi qenë edhe në Forumin e Gruas edhe në kryesi. I morëm udhëzimet qysh m'i majtë qebët, qysh m'i mbajtë dritaret që mos me kërsit xhamat e sene e krejt. Po s'i ka thanë njeri sado kudo edhe krejt pa përvojë e asine... çka me bo, tek me bo djalin e vogël thom, "Hajde t'i marrim do shishe t'i bojmë

ato mollotov e t'i lam te shkalltë. Na hift dikush bile qato t'ja gjujmë". Mas tre-katër mujve kur i kom pa aty që kanë qenë, kisha harru që i kishim lanë na. More kush i ka lanë këto shishe këtu? Kur po m'bjen në mend, ato janë mollotov.

Vështirë ka qenë, frikë ka qenë. Kisha tani edhe vajzën me vajzën e vogël. Ajo banonte poshtë, erdh këtu bash qatëherë kur bombardojshin. Frika ishim mbulu me qepe me asi. Tash bojshim roje, dikush hypke naltë me pa rrugën këtu, me rend. Sa ka zgjatë tre muj e sa unë s'i kom deshë pantollat. Kurrë në jetë tem farmerka s'kom veshë. T'kujna i kom marrë nuk di veç fap {onomotope} ni blluzë, kurrë s'jom deshë. Me qenë gati. Ditën e parë tham hajt po bojmë diçka në tavan a din. P'e hypi djalin e vajzën. Thojsha, more zot po me bo me ra në tavan, a din në qeremide ma zi. Qitu ku jemi të gjithë s'kena çka me ba. Po kalum.

**Anita Susuri:** A ju ka ardhë dikush me ju largu?

**Mejreme Shema:** Jo, këtu s'kanë largu, nuk kanë largu. Kanë ardhë kanë hy deri në shpi, dy herë kanë hi mrena. "Kond e keni?" I kom tregu, "E kom vëllaun me familje", "A keni dikond t'hujë?" Thashë, "Jo s'kom kërkond", edhe nime s'kishim. Tani ma vonë dikur jo çika tezës me burrin e vet ishin kanë dikund e erdhën nga dy ditë a tre.

Mandej ni natë erdhën natën të Podujevës dikush që kanë shku me dalë në Shkup atje e s'kanë mujtë e janë kthy. S'kishin ku me shku, "O s'kena ku me shku, a bon? Kena kërsit secilën derë kërkush s'na ka çelë derën", "Hini mrena. Qe ni dhomë, qitu çka kom, çarçafa e sene", "O s'po dojna as bukë as kurgjo hiç, nesër në mëngjes kthehemë". Nime u çun në mëngjes shkun. Shyqyr zotit pa asni problem.

Ka pasë, vishin rrishin s'kishin çka me bo jo dilsha me kojshi me pi ni kafe, tamon t'u u kthy prej kojshisë e nali kojshinë. Ta rrehin policia para derës. Erdha naltë ktu p'e shoh p'e rrehin. "O Isak p'e shoh p'e rrehin", qishtu, qishtu. Ajo gruja vet i kishte do studenta të Klinës. Kapërcej gardhin e këtu e te kojshitë tjetër, aty s'ish kërkush e në qosh qatje. Thashë, "Rrini qatje derisa t'ju boj me dorë që kanë shku edhe vini". E harroj burrin që e kanë rreh. Ai hini burri i shkreti n'shpi menzi t'u hi, çka me bo.

Kapërcej gardhin e drejt në shpi te kojshia. "O Anton, a je mirë? A ke nevojë diçka?" "Mirë jam", thashë, "Rri edhe pak se s'dihet a kthehen a s'kthehen tani kthehet edhe Vera vjen". Kqyr në atë anë s'pat' thom, "Hec Verë, shko". E vallahi goxha shumë e rrehën, goxha shumë. Nuk ka pasë asi që me largu asi po njerëzit m'largojshin. Sa u marrshin vesh hajde po bojmë diçka e po bojna roje kur të nesrit ikshin, "Po shkojna". Thojshin, "Valla Mejrem po duhet me shku se jo fëmija", "Po çka po m'thoni mu", "Po çka me bo", thashë, "Unë s'e kom ndërmend me shku kërkund, qitu jom".

Do tani u kthyn, s'i kishin marrë, u kthyn. Kur po i shoh dritat kallë thashë kush ka hi, problemi që ka hi dikush tjetër. Kur po del, "Jo na kanë kthy", thashë, "Mirë boll ua kanë bo, hajde rrini në shpi". Po nuk ka pasë diçka këtu. Dy-tri herë do lera shkojshin i shkeplshin tamon vijshin te na u harxhojshin. "Hajt se

vijna i bijna". T'u shku njerëzit t'u i marrë se kur të përfundon lufta kanë me na dhanë pare. O çfarë pare, ata e kishin me bo sa kanë mbetë, sa njerëz, me pasë nifar' përqindje edhe me qata me lanë. Hajde mirremi vesh, bojmë ni marrëveshje diçka.

Na s'shkum m'i marrë, jepshin te "Bankosi" qaty, as s'shkum m'i marrë as s'erdhën tani me na dhanë a diçka. Tërheqja qysh u bo kuptohet mirë. Pastaj ma herët që u bo kjo familja e Jasharajve edhe ajo ka qenë ni, si të themi, mjaft e vështirë e sene. U mblohdhëm gra e mësuse e krejt. Bile e kom shkru ni, marshi i grave... Xhemajlinë e se e takova edhe Xhemajlinë aty. Me çu bukën në te Jasharajt. Ishte simbolike se çfarë buke ki me çu, na nalën hala pa shku në Fushë Kosovë, "Kthenu", u kthym. Unë u dashke m'u bo gati me shku, dilsha përpara me shku në punë, ato shkojshin u kthejshin te Ambasada Amerikane atje m'i lanë buktë e ato kishe që s'na lanë me shku. A din, qisi sene, demokratike pa probleme.

**Anita Susuri:** Përfundoj lufta, kur kanë ardhë trupat e KFOR-it...

**Mejreme Shema:** Kom dalë me vajzën kom dalë asine. Bash te "Grandi" i takova do kësi gazetar, ata frangjisht na anglisht. Po i tregojmë që qishtu ka qenë, qishtu osht'. Vajza anglisht, tani u inkuadrun në këto rrjedha. Shkojke tani përkthejke në luftë, atje ku janë ba lufta e sene, kur janë vra njerëzit. Sidomos kjo BBC, Anglia, Londra ka pasë shumë. Edhe ajo e ka marrë si t'themri me dalë se osht' plagosë te Jasharajt kur ka shku me inxhizu e ka kap plumbi. Po e ka pasë këtë telefonin edhe në telefon funtat, këto funtat, paret edhe qajo e ka shpëtu...

**Anita Susuri:** Atë gazetarin?

**Mejreme Shema:** Atë gazetarin. E ka shpëtu, e ka marrë ni mulli te Jasharajt, e ka atë mullirin. E shpesh tash ka qenë disa herë këtu, ka dhanë intervistë e sene. E fotografitë e para janë prej tyne që janë fotografu, fëmitë t'u ikë e t'u dalë atje, atje. Për të gjithë ka qenë vështirë, për të gjithë. Po se çka u bo kah fundi, në fund si t'them, kush ta bon ma keq se vetja, kërkush s'ta bon. Se ta bon dikush tjetri të mbron a kur e bon vet t'keqe s'mun mbrohesh prej kërkujt.

Se u morën me do sene të kqija, me plaqkitje e sene tani u irritu edhe populli prej ushtrisë. Do të thotë s'paskan luftu me shliru Kosovën po paskan luftu për me marrë pushtet edhe me pasë pasuni. Ai avaz po vazhdon hala. Tash kudo që merr, nëse punon diçka mirë, ky s'po është me këta. 20 vjet e majte dreqi e marrë, e tana i nënshkrove e tash për dy vjet po don krejt me dalë s'munet. Për dy vjet ni temel s'mun e rregullon.

**Anita Susuri:** Zonja Mejreme, nëse doni edhe diçka për fund me shtu, nëse keni harru diçka ose doni edhe diçka me...

**Mejreme Shema:** Po shiko, kurrë nuk thuhen të gjitha. Se i bijnë në mend ma vonë e diçka e sene. Mandej janë do sene diqysh që njeri i man pak, mendon m'i dhanë në forma të ndryshme tjera. Se nuk janë bash për kështu po janë ndoshta si kujtime, si... po thom, krejt thom, mirë, më vjen mirë që kom qenë pjesë do të thotë e të gjitha ktyne lëvizjeve i kom përcjellë. Ndoshta jo shumë aktive domethonë se thom e kom pasë ba që nuk hy dikund kur nuk e di kush janë e tek janë. Kështu ma mirë kontribojoj në forma tjera e sene sesa me shku.

Nuk osht' qëllimi me shku në burg, nuk ka qenë qëllimi. Sikur t'kishte qenë Adem Demaçi prej burgut t'parë ni desident m'u largu shumë ma mirë do t'kish pasë. Prej burgut s'munësh me bo kurgjo. Ai ka sakrifiku jetën, ka sakrifiku rininë. Vitet ma të mira, familjen e krejt. E çka? Në rregull krejt ama në burg... edhe ai vet e ka thënë, "Prej burgut s'munësh me bo kurgjo". Munden njerëzit me bo iluzione e sene se s'ke mundësi, je çdo minut i mbyllur s'ke... po njerëzit krijojnë iluzione, krijojnë dikush ashtu, dikush ashtu.

Po unë thom që kaniherë tash ajo me veteran u bo keq, do të thotë, u rrit numri edhe tash mos bon probleme. Nuk osht' rroga minimale për veteran, rroga minimale është për ata që punojnë, e mundësia me ia dhanë rrogën qikaq tjetër me ia dhanë nér' dorë. Mos me pagu tatimin do të thotë. Nifar' mënyre me, qysh me thanë, me marrë për veti. Njerëzit jashtë nuk i bojnë këto. 40 përqind për shembull në Austri ki me dhanë për shtetin. Mirëpo i ki kushtet, i ki tanat si duhet. Këtu 2 prqind, 3 përqind nuk shkon. Janë, po thom, do sene po ndoshta me kohën duhet, nuk duhet... me bo prioritet çdo gja. Ata që të kanë ndihmu, të kanë ndihmu ama nuk munësh me qenë gjithmonë... duhet me ditë o' kështu o' ashtu.

Kurse tantë, analist, gazetar, ma shumë po ju dhimet Serbia se Kosova. Janë në gjendje me përbi Albin Kurtin, unë nuk di pse, a din. Kur qito sene i kanë bo vet, i kanë nënshkru. Tash, "Jo ti na prishe me Amerikën", po kush të prishi more me Amerikën? Amerika i ka puntë e veta e din çka bon e tek bon e sene. As s'nin për Albinin as tjetrin, ajo e ecë rrugën e vet. Po normalisht i ka do norma, do sene. Osht' çështja globale osht'. Nuk osht' ajo veç e Kosovës po është çështja globale. Do të thotë ndryshimi global. Këta tontë, katastrofë. Kur i dëgjoj kaniherë thom a janë normal (qeshë).

**Anita Susuri:** Ta mbyllim intervisten ma diçka pozitive, ju sot jetoni këtu në Prishtinë, jeni e penzionune a po mirreni me shkrime a diçka?

**Mejreme Shema:** Po, po. Unë kom punu edhe në Rrjetin e Grus domethonë kur kom dalë prej sindikatës do të thotë 2000-ten e kemi lanë sindikatën e arsimit. Unë kom mbetë në Bashkimin e Sindikatave të Pavarura edhe e kom formu Rrjetin e Gruas Sindikaliste, në nivel Kosove. Kom bashkëpunu me rrjetin ndërkombëtarë të sindikatave të botës, të Europës. M'ka ra rasti me shku, do të thotë, pothuajse gati në të gjitha vendet e Jugosllavisë, përveç në Beograd s'kom shku asniherë. Edhe u arsyetojsha, "S'kom pashaportë. S'kom ku i nxjerri", atëherë s'kom shku.

Megjithëse bisedat e këto seminaret u bojshin edhe në gjuhën serbo-kroate se marrshin shumë pjesë edhe ruse, rusisht, frangjisht. Po nuk u bojke në shqip se kishte pak, na edhe Shqipnia. Ata u ankojshin bojshin do probleme do sene, unë s'u ankojsha se unë dijsha edhe serbisht edhe anglisht edhe shqip. Do cikrrime të vogla e sene. Po kemi kontribu, kemi dhanë ni kontribut shumë të madh të madh gjatë kësaj periudhe. Prej vitit 2000 e deri në 2014-ten e kom udhëheq si koordinatore e Rrjetit të Grave Sindikaliste.

Kemi bo aktivitete të shumta, fushata. Krejt tash çka po i bon qeveria, me qeverinë që po i bojnë na i kena bo me sindikatat. I kemi çu letër kryeministrat, i kemi çu letër bashkimit të sindikatave e të gjithave tjerëve. Vallahi kush s'na ka përgjegj e sene. E tash osht' nevoja. Krejt qato, krejt i kom dokumente e sene. Tash me qato po mirren këto shoqatat e këto. Kom marrë pjesë në disa ma vonë e sene, nuk po më pëlqen ajo si barazia, barazia gjinore.

Barazia gjinore nuk është abstrakte, nuk vjen prej qiellit. Duhesh me kriju rrëth ma së pari në familje. Nëse ti nuk ki mirëkuptim në familje edhe nuk e ndryshon pak familjen e fëmitë e tu tash s'munësh me ndryshu ti në publik e sene. E nuk duhet me personalizu. Unë jom nda prej burrit edhe tash krejt burrat janë të këqi. Ose tjetri, tjetri, tjetri sene. Po duhesh me marrë ti çka ke kontribu në atë familje për barazinë gjinore. Unë për veti kom punu shumë me fëmi edhe kurrë s'i kom nda vajza a djali kurrë diçka, barabart. Nuk guxon kërkush me thanë jo ti je vajzë ti s'bon ashtu. Janë rritë me qat' mentalitet edhe sot kontribojnë.

E kom vajzën profesorëshë në Fakultetin e Muzikës, është analiste. Ka punu me gjermant te kjo Fridrih Herbert Stiftung<sup>3</sup>, do të thotë, që është marrë me sindikatat e shoqatat e krejt. E thotë, ni fjalë e thotë si duhet. E ia marrin kaniherë, jo pse po gutesh, po duhesh me thanë. Ma mirë me thanë si duhet sa me tjetri. Po te na as nuk dëgjon çka thotë, krejt, kuku çka u bo s'po marr vesh kur çka po thotë (qeshë). Po thom, kom punu shumë edhe kemi, jemi angazhu me gra me vajza me krejt. Po pak ka qenë, ka qenë niveli ultë. Sepse edhe sindikatat nuk kanë funksionu si duhet.

Njerëzit e politikës nuk janë marrë me gratë, me këto sene. Ma tepër janë marrë me do sene tjera e sene. Tek tash veç ka fillu nifar' forme ma e re, ma mirë pak m'i kombinu këto të drejta. Unë nuk jom adhuruese e asaj me marrë grujen është përla me burrin ose e ka rreh burri me qit' jashtë me shku me ni shpi me çu me nejt me fëmi, jo. Unë e kisha marrë e kisha qit' burrin prej shpisë. Ashtu siç bon krejt bota. Gruja, nana me fëmi ka me nejt në shpi. Ti bon çka t'dush. Qite në gjyqj ndaju ajo është punë e jote.

Po përderisa gjyqji konstaton domethonë ajo ka me nejt në shpi. Ku me shku ajo? Ni banesë dhetë veta vijnë përlahen, rrehen, shahen, probleme të ndryshme. Po krijon edhe probleme tjera, probleme të

---

<sup>3</sup> Fondacioni Friedrich Ebert është fondacioni më i fortë nga të gjitha fondacionet politike gjermane me shpenzime totale prej 190.3 milionë euro në vitin 2019. Ndodhet në Bon dhe Berlin, ka 18 zyra rajonale ose shtetërore në mbarë vendin dhe 104 zyra në mbarë botën (që nga viti 2024).

ndryshme. Mirëpo këtu nuk funksionon ligji ende si duhet se ish dashtë. Burri është ai që ma lehtë del edhe gjen mundësi tjera. Mirëpo këta burrat tonë, "Shpija osht' e babës, e nanës nuk osht' e jemja", gjejnë mënyra gjithmonë m'i ikë obligimeve.

**Anita Susuri:** Në rregull zonja Mejreme, të faleminderit shumë, ishte knaqësi!

**Mejreme Shema:** Faleminderit edhe prej juve!